



# USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 32 (827887)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 16 gusht 2024

## Ministri Vengu: FA, në luftë me flakët e zjarreve, në misionin e tyre në mbrojtje të jetës



# Ministri Vengu, takim me të ngarkuarën me punë të SHBA-ve në Tiranë Nancy VanHorn: Të angazhuar për forcimin e bashkëpunimit

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu priti në një takim mirëseardhjeje të ngarkuarën me punë të SHBA-ve në Tiranë, Nancy VanHorn, të cilës i uroi mirëseardhjen në Shqipëri.

Duke nënvizuar lidhjen e fortë strategjike të vendit tonë me SHBA-të dhe rolin e pazëvendësueshëm që ato kanë në proceset transformuese në Shqipëri, ministri Vengu shprehu angazhimin për të thelluar bashkëpunimin në fushën strategjike të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Gjatë bisedës, ministri u ndal në prioritetet kyçe të Ministrisë së Mbrojtjes si: transformimi dhe modernizimi i FARSH-së, projektet me impakt strategjik të shumëfishtë për vendin, siç është porti ushtarak i Porto Romanos, rijetëzimi i industrisë ushtarake në vend, apo edhe angazhimet e detyrimet politike, institucionale dhe ushtarake në NATO.

Ministri Vengu dhe e ngarkuara me punë e SHBA-ve, VanHorn, vlerësuan nivelin e lartë të bashkëpunimit sa i përket modernizimit dhe kapaciteteve, për ta çuar atë në nivele më të larta, nëpërmjet projekteve madhore.

Nga ana e saj, znj. VanHorn falënderoi ministrin për pritjen dhe shprehu mirënjohjen për rolin kyç që luan Shqipëria si aleat luajal i SHBA-ve në arenën ndërkombëtare, duke e siguruar ministrin e Mbrojtjes për mbështetje të vazhdueshme nga ana e të gjithë stafit të ambasadës, personelit ushtarak dhe civil amerikan të mbrojtjes, që është prezent në vendin tonë.

Në fund të takimit ministri Vengu dhe e ngarkuara me punë e SHBA-ve VanHorn nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit për



vendosjen e Këshilltarit të Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes pranë Ministrisë së Mbrojtjes, z. Randy Hinton.

Z. Hinton do t'i bashkohet kështu katër këshilltarëve të tjerë amerikanë që ndërveprojnë në baza ditore me stafin civil dhe ushtarak shqiptar, në fushën e burimeve logjistike, personel - rekrutimit si dhe sigurisë kibernetike.

## Forca Ajrore realizon me sukses misionin për shuarjen e zjarreve

Deri në momentin e normalizimit të situatës së zjarreve, në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile dhe autoriteteve vendore, do të vijojë mbështetja nga mjetet ajrore rumune tip C-27J, "Spartan" dhe C-130 "Hercules" në operacionet për shuarjen e zjarreve, të cilët do të operojnë nëpërmjet Bazës Ajrore Kuçovë drejt rajoneve të prekura nga emergjencat e rënies së zjarreve.

Janë angazhuar në total 30 persona, me detyrë pilotë, teknikë helikopteri, kontrollorë, personel i shërbimeve mbështetëse. Qëllimi kryesor ka qenë izolimi i plotë i vatrave të zjarrit në zonat Gjirokastër, Korçë, Vau Dejës, Fushë-Krujë, Bulqizë.

Pavarësisht erërave të forta, të cilat në disa zona, kanë vështirësuar aksionin për shuarjen e zjarreve, gatishmëria, angazhimi dhe bashkëpunimi i personelit të Forcës Ajrore nuk ka munguar, duke realizuar 10 misione.



## Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dima priti në takim atasheun ushtarak të SHBA-ve në Shqipëri, kolonel Eric Coté

Kolonel Eric Coté dhe komandanti i ekipit trajnues SATMO, u njohën nga afër me zhvillimet dhe planet e modernizimit të Forcës Ajrore, ku në fokus të veçantë ishte Baza Ajrore e Kuçovës, implementimi i fazës së parë të projektit GAG, si dhe vazhdimi i bashkëpunimit me "Lockheed Martin" për mbajtjen në gatishmëri të SIVHA.

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Dima i falënderoi për kontributin e dhënë për riparimin dhe mbajtjen në gatishmëri të helikopterëve UH60 "Blackhawk".

Në përfundim të takimit, atasheu amerikan konfirmoi vazhdimin e mbështetjes për Forcën Ajrore, si në drejtim të projekteve të zhvillimit të modernizimit ashtu edhe për mbështetjen në trajnimin e pilotëve dhe teknikëve gjatë viteve të ardhshme.

# Ministri Vengu: FA, në luftë me flakët e zjarreve, në misionin e tyre në mbrojtje të jetës

Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kanë diskutuar mbi strategjinë në vazhdimësi për t'i bërë ballë situatës delikate të zjarreve në vend. Jo vetëm angazhim i forcave ushtarake dhe atyre të AKMC në terren, por edhe koordinim më i mirë për ta bërë sa më efektive punën e tyre përkrah forcave zjarrfikëse. Ky ishte fokusi i takimit që ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu organizoi me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji dhe drejtuesin e AKMC-së, Haki Çako. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu u shpreh se paralajmërimi i hershëm dhe reagimi i shpejtë janë çelësi i suksesit për ta përballuar këtë situatë.

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, nënvizoi se në operacionet për shuarjen e zjarreve, në koordinim edhe me AKMC-në janë angazhuar 4600 trupa në terren, helikopteri "Cougar", ndërsa helikopteri shëndetësor është në gatishmëri të plotë. Po ashtu, sipas shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, janë në dispozicion edhe helikopterët "Black Hawk" e flota detare. Gjeneralmajor Arben Kingji tha se janë marrë masat e plota logjistike për realizimin e misioneve për shuarjen e zjarreve, ndërsa Qendra e Bashkuar Operacionale është në dispozicion 24 orë.

Ndërkohë kreu i AKMC-së, Haki Çako bëri një përmbledhje të situatës në terren, duke shtuar se janë regjistruar 40 vatra zjarri në 24 orët e fundit, nga të cilat pjesa më e madhe janë menaxhuar me sukses. Problematike, sipas z. Çako janë vatrat në terrene të thyera. Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së falënderoi stafin e Forcës Ajrore që ka parandaluar situata të rrezikshme për qytetarët. Sipas z. Çako, ndërhyrja e dy avionëve rumunë në Parkun e Prespës dha një rezultat pozitiv dhe tashmë zjarri në këtë zonë është nën kontroll dhe po shkojmë drejt izolimit të plotë. Në këtë takim u vendos që në vijim të informimit sa më të mirë dhe të plotë të publikut, AKMC çdo ditë në orët e para, duke nisur nga e premija do të bëjë një përmbledhje rreth situatës së zjarreve në të gjithë territorin e vendit dhe masave të marra.



Situata e zjarreve në vend, sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, në të gjithë territorin e vendit janë identifikuar 20 vatra zjarri. Pas një pune të pandërprerë të forcave operacionale në terren u bë i mundur izolimi i plotë dhe shuarja e 6 prej tyre, ndërsa 14 vatra vijojnë të mbeten aktive.

Në Parkun Kombëtar të Prespës në Malin e Thatë, vijon puna për shuarjen e zjarrit që zhvillohet në një terren të vështirë dhe me bimësi



lehtësisht të djegshme. Në operacionin e sotëm u angazhuan avioni rumun C-27J "Spartan", forca nga bashkitë e Pogradecit, Pustecit dhe administrata rajonale e Zonave të Mbrojtura. Forcave në terren u erdhën në ndihmë 103 efektivë të Forcave të Armatosura dhe 10 mjete.

Në fshatin Rajë dhe Geghysen, në bashkinë e Tropojës vatra e zjarrit është izoluar, por vazhdon monitorimi nga forcat bashkiake. Nuk paraqet rrezik për përhapje.

Në Bjeshkën e Bollotekut në afërsi të lumit të Gashit vatra është aktive në pyje ahu dhe pishë e zezë. Viojnë përpjekjet për izolimin e vatrës që për shkak të terrenit mori përmasa.

Në fshatin Tërnovë, bashkia Bulqizë ka rënë intensiteti i zjarrit, por vijon monitorimi. Zjarri është nën kontroll dhe nuk paraqet rrezik për përhapje.

Në fshatin Luzni të bashkisë Dibër vatra është izoluar dhe po mbahet nën kontroll nga forca të administratës rajonale të Zonave të Mbrojtura.

Në fshatin Ujanik, në bashkinë e Skraparit, zjarri është aktiv për shkak të terrenit shkëmbor dhe pjerrësisë, gjë që e bën tejet të vështirë ndërhyrjen e forcave nga toka. Vatra po zhvillohet në drejtim të "Vendit të Shenjtë", ku është stacionuar një mjet zjarrfikës.

Mbi fshatin Sotirë, në Dropullin e Sipërm zjarri është aktiv, por me intensitet të ulët. Në mbështetje të forcave shkuan 15 trupa dhe 1 mjet i FA-së.

Një vatër zjarri në drejtim të fshatit Sopik,



të njësisë administrative Pogon, flakët e të cilit kanë mbërritur nga territori grek, po mbahet nën monitorim.

Në fshatin Sinanaj, zjarri i rënë në një sipërfaqe pyjore, nuk përbën rrezik për përhapje. Pa rrezikshmëri paraqitet edhe vatra në fshatin Reshepaj, të bashkisë Selenicë.

Në vendin e quajtur "Syri i Kaltër" në fshatin Theth, të bashkisë Shkodër, forcat operacionale po punojnë për të shmangur përhapjen e zjarrit.

Në vendin e quajtur "Bjeshkët e Gjurajve", në bashkinë e Shkodrës, zjarri po zhvillohet në

një sipërfaqe pyjore në terren të thepisur dhe të vështirë për të operuar. Zjarri po monitorohet nga strukturat vendore të bashkisë Shkodër. Nuk paraqet rrezik për banesa.

Zjarri në vendin e quajtur "Guri i Nënshetgut", në fshatin Theth, po mbahet nën monitorim nga forcat operacionale dhe vullnetare.

Nën bashkërendimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Forcat e Armatosura kanë përforcuar kapacitetet e ekipeve të pushtetit vendor në betejën për izolimin e vatrave në terrene të vështira.



## Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, takim mbi masat e marra për zhvillimin e stërvitjes “Mountain Eagle”

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, i shoqëruar edhe nga atasheu ushtarak amerikan, kapiten i Rangut II Eric Cote, zhvilloi një takim pune në garnizonin e Vaut të Dejës, në Regjimentit të Këmbësisë Veriut. Fokus i këtij takimi ishin masat dhe përgatitjet e duhura për zhvillimin e stërvitjes “Mountain Eagle”, e cila do të zhvillohet në rajonin e Mrellës nga data 1-7 shtator 2024, me pjesëmarrjen e efektivave të Forcës Tokësore dhe trupave të korpusit të marinës së ushtrisë amerikane. Stërvitja “Mountain Eagle” është një stërvitje taktike, me veprime praktike bashkëvepruese në fushën e luftimit, duke zhvilluar dhe qitje me armët e lehta të këmbësisë.



Më pas, takimi ka vijuar me një prezantim të komandantit të Regjimentit të Këmbësisë së Veriut, kolonel Ali Mali, mbi detyrat, misionin dhe zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe modernizimit në Regjimentin e Veriut.

Gjithashtu gjatë këtij takimi u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit midis dy ushtrive tona në drejtim të modernizimit, trajnimit dhe stërvitjeve të përbashkëta.

## Anija veliere italiane “Palinuro” zhvilloi një vizitë në portin e Durrësit

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në Portin e Durrësit u zhvillua një vizitë nga anija veliere italiane “Palinuro”, pjesë e Forcës Detare italiane.

Qëllimi i vizitës së anijes italiane ishte trajnimi praktik i lundrimit të oficerëve dhe nën-officerëve të rinj të Forcës Detare italiane, dhënia e kontributit në projeksionin e imazhit të Forcës Detare italiane nëpër botë dhe zhvillimi i trajnimeve dhe aktiviteteve dypalëshe ushtarake me vendet aleate të Italisë, e cila u shërben për forcimin e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet vendeve gjatë zhvillimit të vizitave portuale.

Komandanti i anijes, kapiten i Rangut II Samuele Mondino, së bashku me një pjesë të ekuipazhit të anijes realizoi një vizitë në Komandën e Forcës Detare/Rojës Bregdetare, gjatë së cilës u prit nga shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut I Arsen Mullaj. Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e shkëlqyer ushtarak ndër vite, benefitet që sjellin këto vizita, si dhe shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet dy Forcave Detare. Gjatë vizitës tre ditore, anija veliere italiane u vizitua nga autoritetet e larta civile dhe ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, si dhe personeli ushtarak i Forcës Detare/Rojës Bregdetare.



## Batalioni i Xhenios kryen operacionin special për eliminimin e rrëshqitjes së gurëve në lagjen Mangalem, bashkia Berat

Një grup pune i specializuar në Kompaninë e Punimeve Xheniere, në Batalionin e Xhenios ka kryer operacionin special xhenier për vlerësimin dhe marrjen e masave për eliminimin e rrezikut nga rrëshqitjet e gurëve në lagjen Mangalem, bashkia Berat.

Pas fazës së rikonicionit të zonës së operacionit për të cilën është kërkuar ndërhyrja nga autoritetet e emergjencave civile, të realizuar nga ekspertët xhenierë, ka filluar puna për sigurimin e perimetrit të zonës, njoftimin dhe evakuimin e popullsisë që ndodhet përreth.

Specialistët xhenierë të pajisur me mjetet e përshtatshme, materialet dhe municionin xhenier të vlerësuar të nevojshëm për kryerjen e këtij operacioni, ka realizuar prishjen e murit të gurit, sistemin e gurëve, dherave duke zbatuar masat e sigurimit teknik dhe duke punuar me kujdes që punimet e tyre të mos rrezikojnë shtëpitë dhe jetën e banorëve, të cilët kryejnë aktivitetin e tyre të përditshëm.



## Kontingjenti XV EOD, realizon me sukses detyrat në kuadër të stërvitjes “Paladin Strike”

Kontingjenti XV EOD, pjesë e grup-batalionit shumëkombësh të Prezencës së Përparuar të Përfortuar të NATO-s (eFP), në Letoni, realizon me sukses të gjitha angazhimet, duke performuar me rezultate të larta në të gjitha stërvitjet dhe detyrat e tjera. Kontingjenti EOD mori pjesë në stërvitjen “Paladin Strike”, duke u radhitur përkrah forcave të tjera aleate të NATO-s, duke bashkëpunuar dhe ndarë eksperiencat në lidhje me teknikat, taktikat dhe procedurat e ndjekura për neutralizimin e rrezikut që vjen nga prania e municioneve luftarake të rrezikshme. Gjatë kësaj stërvitje efektivet e togës EOD, zgjidhën me përgjegjësi detyra dhe situata, duke treguar nivel të lartë përgatitje profesionale.

Efektivët e kontingjentit EOD, në përfundim të stërvitjes “Paladin Strike”, u vlerësuan maksimalisht nga drejtuesit e grup-batalionit shumëkombësh.





Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Shqipërisë u krijua më 16.08.2001, në përputhje me ligjin Nr.8571 datë 27.01.2000 “Për Politikën e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë” dhe Urdhrin e Komandantit të Përgjithshëm të FA-së, datë 08.04.2000 “Për kalimin në strukturën e re organizative të FA-ve të Republikës së Shqipërisë”. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes organizon dhe drejton përgatitjen, arsimimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të oficerëve, nënoficerëve dhe drejtuesve ushtarakë për të tri llojet e forcave; përpunon dhe sinkronizon koncepte doktrinale bazë të organizimit dhe përdorimit të Forcave të Armatosura në përputhje me Strategjinë e Sigurimit, Politikën e Mbrojtjes dhe Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë, përpunon dhe përmirëson programet, standardet dhe kërkesat për stërvitjen e ushtarëve të nënrepartëve, repartëve e njësive në interes të rritjes së aftësive luftarake të Forcave të Armatosura. Komandantët dhe drejtuesit ushtarakë të të gjitha niveleve në Forcat e Armatosura të Republikës janë përgjegjës për përgatitjen e ushtarëve, detarëve dhe pilotëve të tyre, për të përmbushur misionet e ngarkuara në kuadrin e betejave apo luftimeve. Për të qenë të suksesshme, forcat tona duhet të stërviten, fillimisht dhe kryesisht për situatë reale të luftës. Forcat e Armatosura duhet të operojnë e të jenë të suksesshme në të gjitha llojet e operacioneve ushtarake, të bashkuara/përbashkëta (Joint) dhe shumëkombëshe. Të jetë i trajnuar dhe i gatshëm, është detyra e parë e çdo komandanti në shërbim të FA-së, me qëllim që të planëzojnë dhe zhvillojnë stërvitje efektive dhe kuptimplotë. Individët, shtabet dhe njësitë, në të gjitha nivelet e drejtimit të FA-së, kanë nevojë edhe për udhëzime nga komandantët e tyre. Zhvillimet e shpejta të FASH në rrugën e integritetit të plotë në Aleancën Euroatlantike, diktojnë konsolidimin dhe përsosjen e sistemit të arsimit të stërvitjes së integruar, duke i dhënë atij vlera të reja, në funksion të krijimit të përvojave dhe realiteteve të reja bashkëkohore, për garantimin e forcimit të vazhdueshëm të një shoqërie të qëndrueshme, demokratike dhe paqësore.

Përmbushja e misionit të FASH kërkon, në radhë të parë, personel të arsimuar, të mirë stërvitur, por edhe të motivuar. Për këtë qëllim, vëmendje e veçantë t’i kushtohet arsimit dhe stërvitjes së fokusuar nga misioni, në përputhje me standarde reale, që u përgjigjen nivelit të zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe atyre të NATO-s. Doktrina e Arsimit dhe e Stërvitjes është projektuar për të gjithë komandantët dhe drejtuesit e tjerë ushtarakë në FA. Një vend të veçantë në këtë Doktrinë zë arsimiti universitar dhe arsimiti profesional ushtarak.

Sistemi Arsimit Ushtarak

Sistemi Arsimit Ushtarak duhet të arrijë një balancë relative ndërmjet koncepteve akademike, realiteteve operacionale dhe perspektivave historike. Përmirësimi i vazhdueshëm i burimeve të mbështetjes, shtimi i informacionit dhe, në veçanti, modernizimi i metodave të shkëmbimit të tij, së bashku me zhvillimin teknologjik, do të ndryshojnë së tepërmi e në mënyrë thelbësore të gjithë stërvitjen në FA. Në këtë kuadër, objektivat që do të synohet të arrihen do të ndryshojnë, ndërkohë që procedurat teknike, metodat e drejtimit, të vlerësimit e të kontrollit do të evoluojnë vazhdimisht nëpërmjet filozofisë: stërvit - vlerëso – ristërvit. Vetëm kështu do të sigurohet vazhdimësia e këtij procesi thelbësor për FA.

Ky institucion realizon mbështetjen e nevojshme institucionale për përgatitjen e personelit të FA-së dhe zhvillimin e një procesi stërvitor të standardizuar. Ai është përgjegjës për përgatitjen institucionale të oficerëve dhe nënoficerëve; për kryerjen e stërvitjes bazë me të gjithë personelin ushtarak të FA-së; për përgatitjen dhe kualifikimin e ushtarëve profesionistë/me pagesë; sigurimin e përgatitjes së drejtuesve të të gjitha niveleve, si dhe sigurimin e mbështetjes së nevojshme për vetëzhvillimin e tyre; zhvillimin e koncepteve, kërkesave, materialeve doktrinale, udhëzimeve stërvitore, manualeve etj. Qëllimi i sistemit të arsimit Ushtarak është të prodhojë një trupë drejtuesish të përshtatshëm dhe që të mendojnë në mënyrë kritike, si oficerë dhe nënoficerë, të cilët të kenë vlerat e duhura, atributet dhe aftësitë për të kryer siç duhet detyrat e tyre dhe që t’i shërbejnë kombit. Këta drejtues duhet të dinë si operojnë Forcat e Armatosura, aleatët ushtarakë, partnerët e Shqipërisë dhe



# Rrugëtimi historik i strukturës arsimore të mbi 45 mijë ushtarakëve elitë



kundërshtarët e mundshëm. Për më tepër, këta drejtues duhet të tregojnë besnikëri, integritet, gjykim kritik dhe përgjegjësi, ndërsa veprojnë në një mjedis sigurie shumë kompleks, shpesh të dyshimtë dhe shumë shpejt të ndryshueshëm. Arsimiti është në thelb instruksioni formal, që kryhet zakonisht në mjedise klase, me njohuri të shtuara, aftësi, mendim kritik, me vendimmarrje të përmirësuar dhe/apo eksperiencë, si produkt i dëshiruar për studentin. Kjo metodologji është në kontrast me stërvitjen, ku një detyrë bazë apo stërvitje përdoret në kushte specifike dhe këtu standardet përdoren për të vlerësuar aftësitë e individit dhe të njësive operacionale. Arsimiti universitar në FA, në kurrikulën e tij, gjithashtu përfshin edhe modulet e edukimit, stërvitjes dhe të trajnimit ushtarak deri në nivelin e togës (për të gjitha armët). Ai siguron vazhdimësinë e përgatitjes dhe ekzekutimin e programit të edukimit të oficerit të ri.

Arsimiti i personelit ushtarak në sistemin e FA realizohet nëpërmjet konsolidimit të vazhdueshëm të sistemit arsimor. Arsimiti i përgjithshëm fillon në Universitetin Ushtarak dhe vazhdon në çdo nivel arsimor të oficerit dhe nënoficerit, në akademitë ushtarake, nëpërmjet kurseve të karrierës. Mësimi është progresiv, i ndërtuar mbi aftësitë dhe njohuritë e fituara

nëpërmjet trajnimit të mëparshëm dhe detyrave operacionale.

Kursi Bazë i Oficerit (KBO) ofrohet për të gjithë oficerët që kanë përfunduar edukimin universitar. Kursi zhvillohet në Shkollën e Trupës për një kohëzgjatje gjashtë muaj deri në një vit akademik. Programi synon në përgatitjen e kursantëve me njohuri të plota teorike e praktike për drejtimin dhe menaxhimin e togës në përmbushje me sukses të detyrave, në kohë paqe, krize e lufte, si dhe jep njohuri për kompaninë dhe përdorimin e teknikës luftarake në specialitetin përkatës.

Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO). Ky kurs realizohet me të gjithë oficerët me gradën toger dhe lejtënant, që kanë katër deri në shtatë vjet në shërbimin aktiv. Kursi i Avancuar i Oficerit shërben si kusht për marrjen e gradës “Kapiten” dhe zgjat jo më pak se 12 javë mësimore. Programi i këtij kursi përgatitet dhe realizohet nga Shkolla e Trupës.

Kursi Bazë i Oficerit të Shtabit (KBOSH), kryhet në Akademinë e Mbrojtjes dhe zgjat tre muaj. Qëllimi i programit është arritja e njohurive bazë për punën në grup, njohuritë e përgjithshme për shtabin dhe detyrat që plotëson ky.

Kursi është përzgjedhës dhe ka si qëllim primar përzgjedhjen e oficerëve më të mirë për të vazhduar Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm (KOSHP). Në programin e këtij kursi përfshihet dhe synohet për një detyrë me zgjedhje në nivel batalioni për operacione luftarake ose jo luftarake. Programi për këtë kurs të krijohet për oficerët e komponentëve tokësorë, detarë dhe ajrorë.

Kursi i Komandantit dhe Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm (KKOSHP) kryhet në Akademinë e Mbrojtjes dhe ka një kohëzgjatje prej një viti akademik. Programi i tij është vazhdim i kursit Bazë të Oficerit të Shtabit; ky kurs të synojë të përgatisë oficerë të përzgjedhur karriere për të plotësuar detyra në pozicione kyçe në komandim kontroll të njësive kryesore të FA, në shtabet përbërës të forcave, në Shtabin e Përgjithshëm, në shtabet e NATO-s, apo në shtabe të ndryshme ndërkombëtarë.

KOSHP duhet t’u japë oficerëve njohuri të thelluara për situatat ndërkombëtare, mbi konceptet bazë për rregulloret e sigurisë e të mbrojtjes (kombëtare dhe ndërkombëtare), për lidershipin dhe procesin e planifikimit operacional, duke futur elementët e parë të stërvitjeve të përbashkëta etj. Në këtë kurs qëllimi është që 10-15% e programit të zhvillohet në gjuhën angleze, si gjuhë operacionale e NATO-s, kryesisht lënda e Operacioneve në mbështetje të Paqes.

Kursi i Lartë i Oficerit (KLO). Kursi i lartë i Oficerit do të kryhet në Akademinë e Mbrojtjes me një kohëzgjatje prej një viti akademik. KLO konsiderohet si vazhdim i njohurive të mara në Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e përgatitjes profesionale dhe të Kursi i Lartë i Oficerit është niveli më i lartë i sistemit arsimor ushtarak Përvetësimi i programit të KLO, me përfundimin e tij, siguron dhënien e gradës “Master” në fushën e mbrojtjes. Jo më pak se 30% e programit të këtij kursi të zhvillohet në gjuhën Angleze, kryesisht modulet e operacioneve shumëkombëshe.

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe i Mbrojtjes (KLMS) kryhet në Akademinë e Mbrojtjes me një kohëzgjatje prej jo më pak se dy muaj. Programi i këtij kursi jep njohuri dhe trajnim analitik për probleme të mbrojtjes dhe të sigurisë, në nivelin kombëtar dhe rajonal, gjeopolitika, menaxhimi i krizave, ligji ndërkombëtar humanitar, konfliktet e armatosura, lufta kundër terrorizmit, etj. Kursi të kryhet 100% në gjuhën Angleze me pjesëmarrjen e autoriteteve civile dhe ushtarake të vendit, si edhe pjesëmarrjen nga vende të rajonit.

# “Shtëpia e Bardhë, vendi me simptomat e pallatit, komfortin e një shtëpie dhe simbolin e harmonisë së vendit”

Shtëpia e Bardhë, historia që do të flasë me zërin e një gruaje

Vendin ku do të ndërtohej shtëpia e Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e zgjodhi vetë presidenti Xhorxh Uashington në vitin 1791. Ndërtimi i shtëpisë së presidentit filloi një vit më vonë, por vetëm në nëntor të vitit 1800 ajo priti banorët e parë të saj. Madje edhe atëherë shtëpia nuk ishte veshur ende me mobilie. Abigel Adams, gruaja e presidentit të dytë të Shteteve të Bashkuara, Xhon Adams, shkruante kështu për shtëpinë e re: “Kjo shtëpi është bërë tashmë e banueshme, por ende s’ka as edhe një mobilie të vetme brenda. Dhomën më të madhe të saj, unë e përdor për të nderur rrobat”. Gjatë luftës së vitit 1812 me Anglinë, anglezët hynë deri në kryeqytetin e vendit, në Uashington DC, i cili ishte i pambrojtur. Presidenti atë kohë nuk ndodhej aty. Para se të linte Shtëpinë e Presidentit, siç quhej atë kohë, Dolli Medison, gruaja e presidentit Xhejms Medison, arriti të shpëtonte nga djegia një pikturë të madhe të Xhorxh Uashingtonit, vepër e piktorit të famshëm Gilbert Stuart dhe disa objekte të tjera të rëndësishme. Ushtarët anglezë i vunë zjarrin Shtëpisë së Presidentit. Shtëpia e Presidentit u rindërtua më vonë, duke ruajtur po atë pamje e arkitekturë. Sidoqoftë pas rindërtimit të saj të gjitha muret u lyen me ngjyrë të bardhë për të fshirë gjurmët e zjarrit. Që nga ajo kohë, amerikanët u mësuan ta thërrisnin shtëpinë e presidentit “Shtëpia e Bardhë”. Në vitin 1902 Kongresi amerikan e bëri këtë emër zyrtar. Pas 100 vjet jete e më shumë nga ndërtimi i saj, skeleti i Shtëpisë së Bardhë filloi të vjetrohej e dobësohej. Në vitin 1948 lindi pyetja nëse Shtëpia e Bardhë duhej të riparohet, duke ruajtur po atë projekt, apo duhej shembur e në vend të saj të ndërtohej një rezidencë krejt e re. Populli amerikan e dha përgjigjen e vet nëpërmjet letrave të panumërta. “Shtëpia e Bardhë” ishte Shtëpia e Bardhë dhe kështu duhej të mbetej duke trashëguar aparencën e saj. Vullneti i popullit fitoi dhe shtëpia e presidentit u forcua por mbeti po ajo, siç kishte thënë Xhorxh Uashingtoni “një vend me simptomat e pallatit, komfortin e një shtëpie dhe simbol i harmonisë së vendit.”

John Adams u bë presidenti i parë që banoi në Shtëpinë e Bardhë. Gjatë ditës së tij të dytë në shtëpi ai i shkroi gruas së tij Abigail një letër, ku ishte dhe një lutje për shtëpinë: “I lutem Perëndisë që t’i japë bekimet më të mira kësaj Shtëpie dhe të gjithë atyre që do banojnë këtu tani e mbrapa. Vetëm burra të ndershëm e të mençur udhëheqshin nën këtë çati”. Franklin Delano Roosevelt e ka gdhendur bekimin e Adams në oxhakun e Dhomës së Ngrënies. Adams nuk jetoi gjatë në shtëpi dhe menjëherë pas tij ishte radha e Thomas Jefferson, i cili dha idetë e tij se si duhej të ndryshohej Shtëpia e Bardhë. Ishte Benjamin Henry Latrobe, i cili e ndihmoi me skicimin e Kolonadave Lindore dhe Perëndimore, krahë të vegjël që ndihmojnë në fshehjen e pjesëve, ku zhvillohen veprimet e zakonshme shtëpiake si larja e rrobave, stalla dhe depoja. Sot, kolonadat e Jefferson lidhin rezidencën me Krahun Perëndimor dhe atë Lindor. Në vitin 1814, gjatë Luftës së vitit 1812, trupat britanike i vunë zjarrin Shtëpisë së Bardhë dhe një pjesë e madhe e Uashingtonit u prek nga zjarret. Vetëm muret e jashtme mbetën dhe ato u desh të shembeshin dhe të rindërtoheshin pasi ishin dobësuar nga zjarri. Pas zjarrit, të dy arkitektët, Benjamin Henry Latrobe dhe Hoban kontribuan në skicimin dhe rindërtimin e Shtëpisë së Bardhë. Portiku jugor u ndërtua në vitin 1824, gjatë presidencës së James Monroe, ndërsa ai verior u ndërtua gjashtë vite më vonë.



Kush është Kamala Harris, gruaja që mori vëmendjen e madhe?

Vendimi i presidentit Joe Biden për t’i dhënë fund garës për rizgjedhje dhe përkrahja që në vend të tij të garojë zëvendës presidentja Kamala Harris i ka dhënë shtytje të fuqishme dhe ka kthyer edhe njëherë vëmendjen e madhe te Harris.

Trajektorja e karrierës së saj prej prokurores në politikane është shquar si flamurtare në shumë fusha: Ishte e para senatore amerikane me prejardhje induse dhe gruaja e parë dhe prokurorja e parë grua e Kalifornisë, njëherësh gruaja e parë me prejardhja jugaziatike në këtë pozitë.

Harris i u bë gruaja e parë që u zgjodh zëvendës presidente, si dhe amerikanja e parë me ngjyrë dhe personi i parë me prejardhje aziatike në këtë post të lartë të politikës amerikane.

Znj. Harris është kandidatja më e mundshme demokrate për zgjedhjet e sivjetme presidenciale,



Harris është në prag që të bëhet presidentja e parë grua e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ja çfarë dihet për jetën dhe momentet që përkufizuan jetën e saj politike.

**Bijë emigrantësh**

Kamala Harris u lind në Oakland në Kaliforni më 20 tetor 1964. Në hyrje të memoareve të saj të publikuara më 2019, “The Truths We Hold”, Harris theksonte se emri i saj theksohet si komala” dhe se ka kuptimin e lules së zambakut të ujit, në nderim të një simboli të rëndësishëm në kulturën e Indisë.

Babai i Harrisit, Donaldi, migroi në Shtetet e Bashkuara nga Xhamajka për të studiuar ekonominë në Universitetin e Kalifornisë në Berkeley. Ai tani është profesor emeritus i ekonomisë në “Stanford”.

Nëna e saj, Shyamala Gopalan Harris, migroi në Shtetet e Bashkuara nga India jugore në fund të viteve pesëdhjetë. Ajo fitoi doktoratën në endokrinologji dhe nutricion në Berkeley dhe u bë hulumtuese e kancerit të gjirit para se të vdiste më 2009.

Harris shkruan se prindërit e saj “u takuan dhe ranë në dashuri në Berkeley derisa po merrnin pjesë në lëvizjen e të drejtave civile”, por çifti u shkurorëzua më vonë kur Harris dhe motra e saj, Maya, ishin të reja.

Harris meritat për gjithçka të arritur ia le nënës për të cilën shprehet: “na formëzoi për gratë që do të bëheshim” dhe që i mësoi të bijat të ndiheshin krenare për trashëgiminë e tyre induse dhe me ngjyrë.

“Emrat tanë klasikë na lidhin me trashëgiminë tonë, dhe jemi rritur me ndërgjegje dhe vlerësim të fuqishëm për kulturën induse”, shprehet Harris në librin e saj. “Nëna ime e kuptoi fare mirë se po i rriste dy të bija me ngjyrë. Ajo e dinte se vendi i saj adoptues do ta shihte Mayan dhe mua si dy vajza me ngjyrë, dhe ishte e vendosur që të sigurohej që të rriteshim si gra me vetëbesim dhe me krenari për prejardhjen me ngjyrë”.

Më 1982, Harris u regjistrua në Universitetin e “Howard-it”, një universitet historikisht i dominuar nga amerikanët me ngjyrë, në zemër të Uashingtonit.

Aty, ajo do t’i bashkohej “Alpha Kappa Alphas”, shoqëria më e vjetër e studentëve me ngjyrë në vend, dhe mori një diplomë bachelori në shkencat politike dhe ekonomi. Ajo më vonë do të bëhej e diplomuara e parë e një universiteti të themeluar për studentët me ngjyrë, që do të zgjidhej zëvendës presidente.

Pas kolegjit, Harris u kthye në Kaliforni dhe ndoqi shkollën e së drejtës në Universitetin “California Hastings”. Kur ndau mendjen të bënte karrierë si prokurore në zyrën e prokurorit të qarkut, Harris tha se e dinte që do të duhej të mbronte vendimin e saj para miqve dhe familjes.

“Amerika ka një histori të vjetër dhe të errët të njerëzve që përdorin pushtetin e prokurorit si instrument padrejtësie”, ka shkruar ajo në memoar. “Por ashtu e dija se çfarë nuk shkante me sistemin nuk kish pse të merrej si fakt i pandryshueshëm. Dhe unë doja që të isha pjesë e atij ndryshimi”.

Pas diplomimit në shkollën e së drejtës, Harris punoi për

tri dekada si prokurore, duke shërbyer si zëvendëse e kryeprokurorit për Alameda County të Oaklandit, para se më 2004 të zgjidhej kryeprokurore e qarkut të San Franciskos.

Më 2011, Harris u bë amerikanja e parë me ngjyrë, gruaja e parë dhe amerikanja e parë me prejardhje induse që do të zgjidhej prokurore e përgjithshme e Kalifornisë.

Gjatë asaj kohe, Harris do të takohej dhe do ta bënte mik djalin e madh të Bidenit, Beau, i cili gjithashtu kishte shërbyer si prokuror i përgjithshëm i Delawaret.

Karriera e Harrisit si prokurore dhe pastaj si zyrtarja më e lartë për zbatimin e ligjit në Kaliforni u vu në dyshim gjatë fushatës së saj për zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, me aktivistët progresivë dhe avokatët e zbatimit të ligjit që vinin në dyshim shumë vendime të saj si prokurore, përfshirë qëndrimin e saj kundër dënimit me vdekje.

Më 2014, Harris do të martohej me Doug Emhoffin, një ish-partner menaxhues në një studio të së drejtës.

Çifti nuk ishin njohur më parë dhe Harris më vonë është tallur në kujtimet e saj se stafi i ishte referuar “asaj epoke si AD – ‘After Doug’”.Emhoff u bë zotëria i dytë i parë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

**Kapërcimi prej prokurores në politikane**

Më 2015, Harris lançoi fushatën e saj për Senatin amerikan, duke synuar ta zëvendësonte senatoren e kahershme të Kalifornisë, Barbara Boxer.

Edhe ish-presidenti Barack Obama, edhe zëvendës presidenti i atëhershëm Biden mbështetën fushatën e saj dhe ajo do të shkruante në kujtimet e saj se ajo natë zgjedhjesh më 2016 ishte “sureale” për shumë arsye – jo veç pse fitoi ajo.

“U zgjodha senatore amerikane, gruaja e parë me ngjyrë nga shteti im, dhe e dyta në histori që e fitonte atë mandat”, - shkruante ajo.

Por derisa po bëhej e qartë se Donald Trumpi do të bëhej presidenti i 45-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Harris tha se hoqi dorë prej fjalimit që e kishte shkruar fillimisht me supozimin se vendi do të zgjidhte presidenten e parë grua, dhe në vend të kësaj “që t’i përkushtoheshin unifikimit të vendit tonë”.

Gjatë kohës së saj në Senatin amerikan, Harris shërbeu në Komitetin e Senatit për Drejtësi, si dhe si pjesë e Komitetit për Inteligjencën para se ta lançonte fushatën për Shtëpinë e Bardhë më 2019.

Gjatë një debati të madh presidencial atë vit, Harris nuk u pajtua me qeverisjen e zëvendës presidentit të atëhershëm, Joe Biden, përfshirë qëndrimin e tij të mëparshëm për disgregacionit dhe ndarjen në autobusë shkollash.

**Si ka qenë si zëvendës presidente Harris?**

Jennifer Victor, një profesoreshë në Universitetin George Mason, e cila merret me studimin e figurave politike e përshkroi Harrisin si një “zëvendës presidente shumë tipike”.

Harris ka inkurajuar kryesisht politikat e nënshkrimit të administratës Biden, duke përfshirë legjislacionin e infrastrukturës, imigracionin, kontrollin e armëve dhe përpjekjet për të mbrojtur të drejtat e abortit. Në veçanti, Harris-it i është ngarkuar detyra të drejtojnë përpjekjet për të frenuar migrimin nga Amerika Qendrore. “Numrat e saj të popullaritetit nuk kanë qenë shumë të larta, por ajo gjithashtu nuk ka pasur shumë mbulim shtypi”, - tha Victor.

“Ajo nuk ka qenë në qendër të vëmendjes së madhe të diskursit politik gjatë viteve të fundit, por mendoj se ajo që do të shohim është një rritje masive”.

Harris e ka përshkruar veten si një “prokurore progresive”, por ajo ka bërë pak ndërhyrje me krahun progresiv të partisë. Ndërsa Harris mbikëqyri disa reforma në karrierën e saj, kritikët e kanë akuzuar atë se në rastin më të mirë kishte një qasje të përzier në politikat e saj. Kjo përfshinte një shtysë të diskutueshme për zbatimin e mungesës së shkollës si prokurore e qarkut të San Franciskos që i bëri prindërit të përballeshin me dënime për mungesën e fëmijëve të tyre në shkollë. Zyra e saj punoi gjithashtu për të parandaluar lirimin e më shumë të burgosurve, pavarësisht mbipopullimit masiv në burgjet e Kalifornisë. Dhe si prokuror i përgjithshëm i shtetit, Harris argumentoi një rast që mbronte përdorimin e dënimit me vdekje në Kaliforni, pavarësisht se ishte personalisht kundër tij.

**Cili është qëndrimi i saj për luftën e Izraelit në Gaza?**

Për sa i përket Izraelit-Palestinës, Harris i është përmbajtur mbështetjes “të hekurt” të administratës Biden për Izraelin dhe ajo ka mbrojtur rregullisht të drejtën e Izraelit për vetëmbrojtje, duke përfshirë edhe gjatë luftës në Gaza.

Ajo do të takohet me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu këtë javë, kur ai të vizitojë SHBA-në.

Megjithatë, Harris ka qenë një nga anëtarët më të zëshme të administratës, duke theksuar katastrofën humanitare që po shpaloset në enklavë. Në mars, ajo u bë anëtarja më e lartë e administratës që përdori fjalën “armëpushim” në thirrjen për një pauzë humanitare në luftime.

Shumë pak kohë ka mbetur nga përballja e ‘titanëve’, njëri prej të cilëve nëpërmjet votës së amerikanëve do të drejtojë ‘Shtëpinë e Bardhë’ emblemën e amerikanëve, pse jo dhe drejtimin e fateve të shumë vendeve të botës.





# A nuk e sundojnë botën ato duar që tundin djepin?

**G**ruaja luan një rol sa kritik aq edhe të rëndësishëm në gjenerimin e virtyteve si dashuria, afërsia, pjekuria, intelijenca, ekuilibri dhe morali i mirë, të cilat janë thelbësore për njerëzimin. Në organizimin social e industrial të shekullit tonë, statusi social i individit përcaktohet përgjithësisht duke marrë në konsideratë nivelin e kontributit të tij në prodhimin ekonomik dhe në konsum. Kjo mënyrë vlerësimi bën që gratë, e veçanërisht shtëpiaket, të përbusen dhe të mos lejohen të fitojnë status social, meqenëse funksionet e tyre nuk merren në konsideratë ekonomiksht. Ky lloj vlerësimi dobëson vetëbesimin dhe vetëvlerësimin e tyre dhe i bën ato të kenë një vizion të turbullt rreth faktit se çfarë roli social duhet të zgjedhin.

Gruaja zë vendin e individit kryesor përcaktues në familje, ashtu sikurse familja përbën elementin thelbësor të shoqërisë. Përveç rolit të saj formues dhe përcaktues, gruaja ka një funksion të rëndësishëm dhe një rol qendror në rregullimin e institucionit familjar, i cili është njësia bazë e shoqërisë në bashkimin dhe unitetin e pjesëtarëve të familjes, si dhe në orientimin direkt të bashkëshortit dhe të pjesëtarëve të tjerë, duke dalë qartë simboli i ekuilibrit nga ana e saj. Roli dhe pozicioni i saj në familje kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi individët për shkak të funksioneve të saj. Për këtë arsye, asnjë sukses që fitohet jashtë shtëpisë nuk mund të kompensojë dështimin e gruas në familje. Prandaj edhe kërkohet një pjekuri dhe ekuilibër brenda shtëpisë së saj, për të lulëzuar më tej këto dy cilësi në shoqërinë ku ajo jeton dhe kontribuon.

Faktet historike tregojnë se shkrirja e strukturës së shëndetshme të familjes është më e rëndësishmja ndër faktorët e shkatërrimit të shoqërive dhe qytetërimeve dhe se kjo shkrirje, që filloi me dobësimin e qëndrimeve dhe të pikëpamjeve të gruas kundrejt mëmësisë, ka arritur fazën e saj finale me degjenerimin e “jetës familjare” dhe të koncepteve mbi “marrëdhëniet seksuale”. Gruaja me cilësitë e saj të të qenët nënë, vazhdon të luajë rolin drejtues për vite me radhë në fazën psiko-sociale të procesit të zhvillimit të fëmijës. Prandaj prezenca e gruas tregon, sidomos në familje, pse jo edhe në shoqëri, politikë, ekonomi, biznes, debat apo polemikë, pjekuri e mendime të ekuilibruara. Për këtë arsye gruas duhet t’i jepet mbështetje intelektuale dhe emocionale në mënyrë që ajo ta zbulojë pozicionin e saj në realitetin social dhe kulturor, pasi shpeshherë abuzohet, madje shumë, kur mendohet dhe thuhet se gruaja, apo femrat në përgjithësi, nisur nga të qenët të brishta,



mendojnë jo thellë dhe tregojnë mefshtësi. Arma më e fuqishme e gruas në përpjekjen e saj për transformimin e shoqërisë në “një shoqëri virtyti” është aftësia për të gjeneruar dashuri, durim e pjekuri. A nuk janë këto virtyte të arta e që nuk kanë çmim? Gruaja është faktori më i rëndësishëm në përcaktimin e bazave të personalitetit dhe të karakterit të individit me marrëdhëniet e saj natyrore të afeksonit dhe të atashimit.

Duke qenë fusha kryesore e përpjekjeve të saj shtëpia, pikërisht aty ajo mbjell atë që presin ta korrin gjenerata që ajo lind dhe tund në djepin e jetës e lumturisë.


Respekt për mundin e saj, fjalën e saj të pjekur e zgjuarsinë e saj mes ekuilibrave të përkryer. Rrjedhimisht, duke u kujdesuar

për këtë shtëpi dhe për ato çfarë ajo përmban, ajo do ketë frytet e veta në këtë botë dhe fryte pa masë nga mirësitë e Zotit të saj. Ka cilësi që u përkasin dy gjinive, por këto cilësi në fjalë, pjekuri dhe ekuilibër i shkojnë më për shtat gruas, dhe kjo nuk është një relikte e një të shkuare të errët, por është bazë e fortë mbi të cilën mund të ndërtohet një shoqëri e shëndetshme në ditët e sotme. Popujt që janë përpjekur ta ndryshojnë këtë rregull natyror nuk shfaqin tjetër vetëm se hidhërim dhe shqetësim për përpjekjet e tyre. Ata janë si të verbrit që kërkojnë kutur rrugën në errësirë, të paafte ta zhbëjnë atë që kanë punuar me duart e tyre dhe të dalin nga llumi ku janë zhytur.

Ekuilibrat, kudo, jo në kuptimin e caqeve dhe barrierave, por në kuptimin e mirë të tyre, prodhojnë pjekuri, maturi, durim e përpjekje të vazhdueshme për arritje e performanca, të cilat do na çonin tek ajo “e mesmja e artë”, ekuilibër ky sa madhështor, aq natyral, i saktë e i qenësishëm e që duhet ta kemi

parasysh në çdo çështje, vendim, gjykim, vendimmarrje, apo edhe çdo detaj tjetër me të cilin na mbështjell jeta në të cilën jetojmë. Kjo jetë, e cila vjen rrëmbyeshëm, herë-herë me dallgë gëzimi e hareje, me dallgë arritjesh e suksesesh, ka edhe dallgë trishtimi, zhgënjimi e dështimi, të cilat përplasen pas teje sikurse pas një shkëmbi, por që nuk dihet në u ngjan atyre shkëmbinjeve të fortë e të mësuar me tekat e këtij deti të gjerë e pafund, me dallgë e oscilacione të pakapshme.

Na takon neve, grave, të jemi gjithnjë në kërkim të mirërritjes brenda nesh të cilësisë së përkryer, pjekurisë së mendimit, fisnikërisë së ndjenjave që mbajnë gjallë një botë të tërë dhe ekuilibrit që do mbante gjallë çdo gjë që rritet brenda nesh.



NATO është e përkushtuar dhe i kushton rëndësi të madhe kontrollit të armëve konvencionale. Aleanca ofron një forum thelbësor konsultativ dhe vendimmarrës për anëtarët e saj mbi të gjitha aspektet e kontrollit të armëve dhe çarmatimit.

**Marrëveshjet konvencionale të kontrollit të armëve**  
**Traktati i Forcave të Armatosura Konvencionale në Evropë**  
Traktati i vitit 1990 mbi Forcat e Armatosura Konvencionale në Evropë (CFE) përmendet si “gur themeli i sigurisë evropiane”. Ajo imponon, për herë të parë në historinë evropiane, kufizime ligjore dhe të verifikueshme në strukturën e forcave të tashmë 32 Shteteve Palë të saj, të cilat shtrihen nga Oqeani Atlantik deri në Malet Ural.

Që nga hyrja në fuqi e Traktatit në vitin 1992, është verifikuar shkatërrimi i mbi 100,000 pjesëve të pajisjeve të kufizuara sipas traktatit (tanke, transportues të personelit të blinduar, artileri, helikopterë sulmues dhe avionë luftarakë) dhe janë kryer pothuajse 6,000 inspektime në terren, duke arritur objektivin e saj për të krijuar ekuilibër dhe për të zbutur mundësinë e sulmeve konvencionale të befasishme brenda zonës së aplikimit.

Në Konferencën e parë të Rishikimit të CFE në 1996, filluan negociatat për të përshtatur Traktatin CFE për të pasqyruar realitetet e epokës së pas Luftës së Ftohtë. Ky proces u përfundua në lidhje me Samitin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Stamboll në 1999. Shtetet Palë ranë dakord gjithashtu për angazhime shtesë, të quajtura Angazhimet e Stambollit. Megjithëse Traktati i Përshtatur CFE (ACFE) shkoi shumë në përshtatjen e Traktatit në një mjedis të ri sigurie, ai nuk u ratifikua nga vendet aleate për shkak të dështimit të Rusisë për të përmbushur plotësisht angazhimet në lidhje me tërheqjen e forcave ruse nga Gjeorgjia dhe Republika e Moldavisë, mbi të cilën bazohej marrëveshja e Aleatëve për Traktatin e Përshtatur.

Që nga viti 2000, në samitet e NATO-s dhe takimet ministrore, aleatët kanë përsëritur angazhimin e tyre ndaj Traktatit CFE dhe kanë riafirmuar gatishmërinë dhe angazhimin e tyre për ratifikimin e Traktatit të Përshtatur.

Gjatë Konferencës së tretë të Rishikimit të CFE në qershor 2006, Rusia shprehu shqetësimet e saj në lidhje me ratifikimin e Traktatit të përshtatur CFE dhe pretendoi se edhe ACFE ishte e vjetëruar.

Pas Konferencës së Jashtëzakonshme të Qershorit 2007 të Shteteve Palë në Traktatin CFE, presidenti rus nënshkroi legjislacionin më 14 korrik 2007 për të “pezulluar” në mënyrë të njëanshme detyrimet e tij ligjore sipas Traktatit CFE që nga 12 dhjetori 2007. Në përgjigje të këtyre ngjarjeve, NATO ofroi një sërë veprimesh konstruktive dhe largpamëse.

Në 2008 dhe 2009, u mbajtën konsultime midis Shteteve të Bashkuara, në emër të Aleancës, dhe Rusisë, por me zhvillim të kufizuar. Përpjekje të mëtejshme për të zgjidhur ngërçin u ndoqën me iniciativën e Shteteve të Bashkuara, e cila kërkoi një marrëveshje për një kornizë për negociatat për një Traktat të modernizuar CFE, në konsultimet në 36 midis të gjitha Shteteve Palë të CFE-së dhe vendeve anëtare të NATO-s që nuk janë palë në Traktatin CFE. Procesi ngeci në vjeshtën e vitit 2011 për shkak të mungesës së marrëveshjes mes palëve.

Në një situatë ku nuk mund të arrihej një marrëveshje për të kapërcyer ngërçin, në fund të nëntorit 2011, Aleatët e NATO-s CFE njoftuan vendimet e tyre për të ndërprerë zbatimin e disa detyrimeve të CFE-së kundrejt Rusisë, duke vazhduar ende të zbatojnë plotësisht detyrimet e tyre në respekt për të gjitha shtetet e tjera palë të CFE-së. Megjithatë, në komunikatën e ministrave të jashtme të dhjetorit 2011, aleatët deklaruan se këto vendime ishin të kthyeshme nëse Federata Ruse do të kthehej në zbatimin e plotë.

Në Samitin e Çikagos në maj 2012, aleatët përsëritën angazhimin e tyre për kontrollin e armëve konvencionale dhe shprehën vendosmërinë për të ruajtur, forcuar dhe modernizuar regjimin e kontrollit të armëve konvencionale në Evropë, bazuar në parimet dhe angazhimet kryesore.

Në Samitin e Uellsit në shtator 2014, aleatët riafirmuan angazhimin e tyre të gjatë për kontrollin e armëve konvencionale si një element kyç i sigurisë euroatlantike dhe theksuan rëndësinë e zbatimit të plotë dhe pajtueshmërisë për të rindërtuar besimin. Ata nënvizuan se aktiviteti ushtarak i njëanshëm i Rusisë në dhe rreth Ukrainës kishte minuar paqen, sigurinë dhe stabilitetin në të gjithë rajonin dhe zbatimin selektiv i Dokumentit të Vjenës dhe Traktatit të Qiejve të Hapur dhe moszbatimi i saj prej kohësh i Traktatit CFE kishte gërryer pozitivitetin e kontributeve të këtyre instrumenteve të kontrollit të armëve. Aleatët i bënë thirrje Rusisë që t'i përmbahet plotësisht angazhimeve të saj. Më 11 mars 2015, Federata Ruse njoftoi se po pezullonte pjesëmarrjen e saj në takimet e Grupit të Përbashkët Konsultativ (JCG) për Traktatin CFE, i cili mblihdet rregullisht në Vjenë.

Në samitet e NATO-s 2016, 2018 dhe 2021, aleatët shprehën se mbeten të përkushtuar ndaj kontrollit të armëve konvencionale si një element kyç i sigurisë euroatlantike, por se aktiviteti ushtarak i njëanshëm i Rusisë në dhe rreth Ukrainës vazhdon të minojë paqen, sigurinë dhe stabilitetin në të gjithë rajoni. Ata përsëritën gjithashtu se zbatimin selektiv i Dokumentit të Vjenës dhe Traktatit të Qiejve të Hapur nga Rusia dhe moszbatimi prej kohësh i Traktatit CFE, i kombinuar me qëndrimin e saj agresiv ushtarak, vazhdojnë të minojnë sigurinë dhe stabilitetin në zonën euro-atlantike.

Në Samitin e Madridit në qershor 2022, aleatët dënuan në termat më të ashpër të mundshëm luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, e cila minon rëndë sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar dhe është një shkelje e hapur e ligjit ndërkombëtar. Dështimi i Rusisë për t'iu përmbajtur detyrimeve të traktatit të saj CFE u demonstrua qartë gjatë raundeve të saj të njëpasnjëshme të ngritjes ushtarake përgjatë vitit 2021 dhe në fillim të vitit 2022 përpara pushtimit të saj në shkallë të plotë të Ukrainës, si dhe gjatë luftës së saj të paprovokuar ndaj Ukrainës që nga shkurti 2022.

# Roli i NATO-s në kontrollin e armëve konvencionale



## Dokumenti i Vjenës

Dokumenti i Vjenës (VDOC), i cili përfshin të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, është një marrëveshje politikisht detyruese e krijuar për të promovuar besimin dhe transparencën reciproke në lidhje me forcat dhe aktivitetet ushtarake të një shteti. Sipas VDOC, mijëra inspektime dhe vizita vlerësuese janë kryer, duke përfshirë vizita në baza ajrore dhe objekte të tjera ushtarake. Llojet e reja të sistemeve kryesore të armëve dhe pajisjeve u janë demonstruar gjithashtu shteteve pjesëmarrëse të VDOC.

Në vitin 2019, Aleatët e NATO-s, së bashku me partnerët e atëhershëm Finlandën dhe Suedinë (tani vende anëtare), paraqitën një propozim të ri për modernizimin e Dokumentit të Vjenës. Propozimi synon të rivendosë besimin, të ndërtojë parashikueshmëri reciproke, të reduktojë rreziqet dhe të ndihmojë në parandalimin e konflikteve të paqëllimshëm. Rusia ende nuk është angazhuar me propozimin e modernizimit dhe vazhdon të zbatojë në mënyrë selektive VDOC. Ashtu si me detyrimet e saj të traktatit CFE, dështimi i Rusisë për të përmbushur angazhimet e saj VDOC u demonstrua qartë gjatë ngritjes së saj ushtarake përpara pushtimit të saj në shkallë të plotë të Ukrainës, si dhe gjatë luftës së saj të vazhdueshme të agresionit.

## Traktati i Qiejve të Hapur

Traktati i Qiejve të Hapur është ligjërish i detyrueshëm dhe lejon fluturime vëzhgimi ajror të paarmatosur mbi territorin e pjesëmarrësve të tij. Deri më tani, më shumë se 1500 misione vëzhgimi janë kryer që nga hyrja në fuqi e Traktatit në janar 2002. Fotografia ajrore dhe materiale të tjera nga misionet e vëzhgimit ofrojnë transparencë dhe mbështetje për aktivitetet e verifikimit të kryera në terren sipas traktateve të tjera.

Ky Traktat parashikon bashkëpunim të gjerë në lidhje me përdorimin e avionëve dhe sensorëve të tyre, duke shtuar kështu hapjen dhe besimin. Pas negociatave afatgjata, Shtetet Palë në Traktatin e Qiejve të Hapur ranë dakord në konferencën e rishikimit të vitit 2010 për të lejuar përdorimin e sensorëve dixhitalë në të ardhmen. Disa Shtete Palë po përmirësojnë aktualisht avionët e tyre dhe po i nënshtrohen procesit të certifikimit të nevojshëm të përcaktuar nga Traktati i Qiejve të Hapur, me qëllim që të vënë në punë avionin në vitet e ardhshme.

Efektiviteti i Traktatit mbështetet në vullnetin e mirë të anëtarëve të tij për të kontribuar në procesin e transparencës. Si përgjigje ndaj zbatimit selektiv të Rusisë dhe shkeljes së përsëritur të këtij traktati ligjërish të detyrueshëm të kontrollit të armëve, Shtetet e Bashkuara u tërhoqën nga Traktati i Qiejve të Hapur në nëntor 2020. Në qershor 2021, Rusia njoftoi vendimin e saj për t'iu tërhequr nga Traktati. Pavarësisht se aleatët i kërkuan Rusisë që të përdorë kohën para se tërheqja e saj të hyjë në fuqi për të rishqyrtuar vendimin e saj dhe për t'iu kthyer në përputhje të plotë me Traktatin e Qiejve të Hapur, tërheqja e Rusisë hyri në fuqi më 18 dhjetor 2021.

## Programi i Veprimit i OKB-së për të parandaluar, luftuar dhe zhdukur tregtinë e paligjshme të armëve të vogla dhe të lehta në të gjitha aspektet e saj

Përhapja e armëve të vogla dhe të lehta (SALW) jo vetëm që ushqen aktivitetet globale terroriste, por gjithashtu inkurajon dhunën, duke prekur kështu popullsinë lokale dhe duke parandaluar zhvillimin konstruktiv dhe aktivitetet ekonomike.

Përhapja e AVL-ve duhet të trajtohet sa më gjerë të jetë e mundur dhe Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC) është një kornizë e përshtatshme për organizimin e kësaj fushe të rëndësishme pune. Grupi i Punës Ad Hoc i NATO/EAPC për AVL-të dhe Veprimin ndaj Minave kontribuon në përpjekjet ndërkombëtare për të trajtuar tregtinë e paligjshme të AVL-ve dhe inkurajon zbatimin e plotë të rregulloreve dhe standardeve ndërkombëtare, duke përfshirë Programin e Veprimit të Kombeve të Bashkuara (OKB PoA).

PoA e OKB-së u miratua në korrik 2001 nga afro 150 vende, duke përfshirë të gjitha vendet anëtare të NATO-s, dhe përmban rekomandime konkrete për përmirësimin e legjislacionit kombëtar dhe kontrolleve mbi armët e vogla të paligjshme, nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe promovimin e ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për këtë çështje. Ai u zhvillua dhe u

ra dakord si rezultat i realizimit në rritje se shumica e konflikteve të sotme luftohen me armë të paligjshme të vogla dhe të lehta, dhe se disponueshmëria e tyre e gjerë ka një ndikim negativ në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, lehtëson shkeljet e ligjit ndërkombëtar humanitar dhe të drejtat e njeriut dhe pengon zhvillimin ekonomik dhe social. Ai përfshin masa në nivel kombëtar, rajonal dhe global, në fushën e legjislacionit, kontrolleve të eksportit dhe importit, shkatërrimin e armëve të konfiskuara, sekuestruara ose të grumbulluara, si dhe bashkëpunimin dhe ndihmën ndërkombëtare për të forcuar aftësinë e shteteve në identifikimin dhe gjurmimin e armëve të vogla dhe të lehta ilegale. OKB-ja mban Takimin Dyvjeçar të Shteteve për të Shqyrtuar Zbatimin e PoA, në të cilën NATO merr pjesë. Delegacionet kombëtare nga të gjitha shtetet anëtare mblihdhen çdo gjashtë vjet për të shqyrtuar progresin e bërë në zbatimin e PoA.

## Veprimi ndaj minave

Megjithëse jo të gjitha shtetet anëtare të Aleancës janë palë në Konventën për Ndalimin e Përdorimit, Grumbullimit, Prodhimit dhe Transferimit të Minave Kundër-Personi dhe për Shkatërrimin e tyre (e quajtur edhe Konventa e Otavës), ata të gjithë mbështesin plotësisht qëllimet humanitare për çminimin e saj.

Aleanca ndihmon vendet partnere në shkatërrimin e rezervave të tepërta të minave, armëve dhe municioneve nëpërmjet një mekanizmi të Fondit të Mirëbesimit të NATO-s/Partneritetit.

Grupi i Punës Ad Hoc i NATO/EAPC për AVL-të dhe Veprimin ndaj Minave mbështet gjithashtu përpjekjet për veprim kundër minave nëpërmjet këtyre projekteve të Fondit të Mirëbesimit, si dhe përmes shkëmbimit të informacionit. Në veçanti, ai ofron një mundësi për ekspertët e veprimit ndaj minave që të ndajnë ekspertizën e tyre me Grupin e Punës. Këta ekspertë janë nga qendrat kombëtare të veprimit ndaj minave, organizatat joqeveritare dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ndonjëherë përfshijnë individë të profilit të lartë si Nobelistja znj. Jody Williams, koordinatorja themeluese e Fushatës Ndërkombëtare për Ndalimin e Minave Tokësore. Grupi i Punës ka zgjeruar fokusin e tij për të përfshirë në axhendën e tij çështjet që lidhen me mbetjet shpërthyes të luftës dhe municionet tëhërmuese.

## Traktati i Tregtisë së Armëve

Në korrik 2012, vendet anëtare të OKB-së u mblodhën në Nju Jork për të negociuar një traktat të tregtisë së armëve që do të vendoste standarde të larta të përbashkëta për tregtinë ndërkombëtare të armëve konvencionale. Pas dy vitesh negociata, Konferenca arriti një marrëveshje për një tekst traktati. Qeveritë nënshkruan traktatin dhe, pas ratifikimit nga 50 shtete, ai hyri në fuqi në dhjetor 2014. Që atëherë, 113 shtete e kanë ratifikuar traktatin. Ai vendos standarde të përbashkëta ndërkombëtare për importin, eksportin dhe transferimin e armëve konvencionale. NATO është e gatshme të mbështesë Traktatin e Tregtisë së Armëve sipas nevojës.

## Projektet e Fondit të Mirëbesimit

Mekanizmi i Fondit të Mirëbesimit të Partneritetit për Paqe u krijua fillimisht në vitin 2000 për të ndihmuar vendet partnere me shkatërrimin e sigurt të rezervave të minave tokësore kundër personelit. Ai u zgjerua më vonë për të përfshirë shkatërrimin e municioneve të tepërta, municioneve të pashpërthyer dhe AVL-ve, dhe ndihmën e vendeve partnere në menaxhimin e pasojave të reformës së mbrojtjes, trajnimit dhe ndërtimit të integritetit. Deri më tani, NATO ka kontribuar në shkatërrimin e 6.2 milionë minave tokësore kundër personelit, 47.808 tonë municione të ndryshme, 642.000 copë municionesh të pashpërthyer, 2 milionë granata dore, 16 milionë nën-municione tëhërmuese, 97.300 raketa raketash tokë-ajër-tokë, 1,635 sisteme të mbrojtjes ajrore të lëvizshme nga njeriu (MANPADS), 3,530 ton kimikate dhe 689,910 SALW, së bashku me 164.4 milion fishekë municionesh SALW. Deri më sot, 4120 hektarë tokë janë pastruar nga minat apo mjetet e pashpërthyer.

Përveç kësaj, mbi 12,000 ish-personel ushtarak kanë marrë ndihmë për ritrajnim nëpërmjet projekteve të Fondit të Mirëbesimit për reformën e mbrojtjes.

## Organet e NATO-s të përfshira në kontrollin e armëve konvencionale

Ka një sërë organesh të NATO-s që ofrojnë një forum për të diskutuar dhe çuar përpara çështjet e kontrollit të armëve. Politika e kontrollit të armëve përcaktohet në kuadër të diskutimeve të Task Forcës së Nivelit të Lartë (HLTF) për Kontrollin e Armëve Konvencionale që u krijua për CFE dhe masat e ndërtimit të besimit dhe sigurisë (CSBM).

Zbatimin dhe verifikimin e marrëveshjeve të kontrollit të armëve bien nën kompetencën e Komitetit Koordinues të Verifikimit (KQV), duke përfshirë mbikëqyrjen e një databaze verifikimi të caktuar të CFE-së.

Forume të tjera përfshijnë Komitetin e Sigurisë së Partneriteteve dhe Bashkëpunimit (PCSC) dhe Grupin Ad Hoc Punues të EAPC për SALW-të dhe Veprimin ndaj Minave, në të cilin organizata zbatuese si OKB-ja, Bashkimi Evropian, OSBE-ja, Shtëpia e Pastrimit për Kontrollin e Evropës Juglindore dhe Lindore i SALW (SEESAC) dhe Agjencia e NATO-s për Mbështetjen dhe Prokurimin (NSPA) mund të ndajnë informacion mbi projektet.

Shkolla e NATO-s në Oberammergau (Gjermani) zhvillon kurse të shumta në fushat e kontrollit të armëve, çarmatimit dhe mospërhapjes. Ato kanë të bëjnë me CFE, VDOC, Qiejt e Hapur, armët e shkatërrimit në masë (WMD), AVL-të dhe Veprimin ndaj Minave. Shumica e tyre janë gjithashtu të hapura për partnerët e NATO-s.



NGA SAKIP CAMI\*

Br. XVIII Sulmuese u formua në Sllatinë të Dibrës, më 18 gusht 1944, sipas urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm të UNCSH-së, mbi bazën e tre batalioneve, të Dibrës, Martaneshit, Çermenikës dhe batalionit të ri që u formua me partizanë të rinj, të ardhur nga krahina të tjera të vendit. Kjo brigadë u inkuadrua në Divizionin I Sulmues, disa nga kuadrot drejtues.

Në drejtimin e Brigadës në ditën e formimit ishin Esat Ndreu, komandant, vëllai i patriotit dhe luftëtarit Elez Isuf Ndreu, Zëvendës komandant Zoi Themeli, Mico Kallamata komisar dhe Sotir Vullkani zëvendës komisar.

Më vonë u bënë ndryshime në komandën e Brigadës. Petrit Dume u bë komandant brigade, Hilmi Causholli, komisar, Xhevdet Petrela, Zëvendës komandant, Teme Sejko, Zëvendës komisar, Milo Qirko Zëvendës komisar.

Gafur Korca ishte komandant i batalionit të parë, Qazim Peshku, komandant i batalionit të dytë, Ajet Rusi, komandant i batalionit të tretë dhe Gafur Mehmeti komandant i batalionit të katërt, Rexhep Doda, komisar i batalionit të parë, Ferit Muha nga Bllaca, komandant i kompanisë parë në këtë batalion, Uke Cami komisar i kompanisë së parë etj.

#### Luftimet kryesore

- Luftimet e kryera së bashku me Brigadën e V Sulmuese në malin e Korabit kundër forcave gjermane që bënë të dështonte faza e fundit e operacionit “fucsjargt” (“gjahu i dhelprave”)
- Kryerja e disa aksioneve luftarake kundër autokolonave gjermane gjatë tërheqjes në rrugën automobilistike Prizren/Kukës/ Pukë dhe lufta për çlirimin e Kukësit.
- Luftimet përtej kufirit shtetëror për çlirimin e qytetit të Dibrës së Madhe, për çlirimin e Kërçovës dhe të Prizrenit.

#### 4 MUAJ LUFTIME TË PËRGJAKËSHME TË BR.XVIII SULMUESE

Fill pas formimit, Brigada u angazhua në luftime çlirimtare. Më 23 gusht 1944 Br.18 çliroi qytetin e Peshkopisë. Pas luftimesh në Inoskë e Korab, forcat gjermane dhe mercenare u tërhoqën në Dibër të Madhe. Batalioni IV luftoi në Shutovë të Kërçovës, ku ranë në atë betejë Ibe Palikuqi, Hakik Xhika, Haxhi Xhediku, Zenel Paci dhe Myrtezan Zuna.

Më 25 gusht, na u dha për detyrë çlirimi i Dibrës së Madhe. Më 3 shtator 1944, u bë çlirimi i Dibrës së Madhe nga forcat e batalionit I dhe II të Br.18 dhe nga Br.V, të cilat arritën të mposhtin sulmet gjermane dhe ato të mercenarëve.

Batalioni i parë u vendos në frontin Bajnisht-Kojnarë, batalioni i katërt u vendos në frontin Bofmollë-Ura e Spiles. Frontet e tjera ishin zënë nga një pjesë e forcave të Divizionit të parë.

Pas 24 orë luftimesh, forcat gjermane në qytet të ndihmuara edhe nga batalioni “Drini”, i komanduar nga Dilaver Dine, u tërhoqën nga Dibra e Madhe. Dibra u çlirua.

Brigada e katërt shqiptaro-maqedonase e drejtuar nga Qemal e Nexhat Agolli dhe ku bënte pjesë edhe Esat Cami mori drejtimin e Strugës dhe më pas të Shkupit.

Brigada XVIII mori urdhrin për të shkuar në drejtim të Kukësit e të Prizrenit, në mbështetje të Brigadës 5 Sulmuese.

Batalioni i parë i komanduar nga Gafurr Korça dhe Rexhep Doda nga mesi i natës filloi marshimin në drejtim të Kalasë së Dodës dhe në orën pesë të mëngjesit sulmon Kalanë, nga Kalla, Vlesha e Sllava dhe nga Zall-Kalisi dhe pas pesë orë luftimesh të përgjakshme u mor Kalaja. Një pjesë e mirë e luftëtarëve nacionalistë u kthyen me ne dhe luftuan deri në fund kundër gjermanëve.

Këtu kemi parë edhe masakrën më të madhe njerëzore, Hajdar Dushin me 22 shokë të vranë, ndërmyet tyre edhe 2 shoqe partizane, të cilat i kishin zhveshur lakuriq dhe u kishin ngulur nga një hu në prapnicë dhe i kishin mbështetur për shkëmbi. Urrejtja ndaj pushtuesit por edhe ndaj atyre që u shkonin pas si nacionalistë e antikomunistë nuk kishte kufi dhe nuk mund të tregohet.

Përsëri njoftohemi se shtabi i brigadës së pestë është në rrezik në fshatin Ujmishtë nga forcat e Muharrem Bajraktarit.

Pas rrethimit që i bëme forcave të Bajraktarit e çliruam shtabin e Brigadës së pestë, por nga kjo brigadë kishin mbetur në luftim 60 partizanë, kryesisht të vranë nga forcat e Muharrem Bajraktarit. Ja ku kishte arritur vëllavrasja midis shqiptarëve, antifashistëve dhe antikomunistëve.

Populli i kësaj zone më shumë mbështeti Nacional-Çlirimtaren se sa Muharrem Bajraktarin dhe u rreshtua në Brigadën e 24 kundër gjermanëve.

Në këto momente tabloja e luftimeve ishte e tillë: Shtabi i Br.XVIII ishte vendosur në Bicaj, shtabi i Br.V në Has, ndërsa

# 80-vjetori i Br. XVIII Sulmuese, brigada që çliroi Dibrën, Kukësin dhe Prizrenin



forcat gjermane dhe mbështetësit e tyre në Kukës e Prizren. Batalioni parë i Br.XVIII së bashku me batalionin e Lumës bënë një aksion tek kulla e Lumës dhe asgjësuan një repart gjerman që vinte nga Prizreni, ku u kap rob edhe qarkkomandanti i Kukësit.

Batalionit të Parë të Br.XVIII iu dha detyrë të sulmonte Topojanin, Zapodin dhe Dragashin. Në Dragash na u dha urdhri për të marshuar drejt Kukësit, ku në fshatin Bardhoc bllokua rrugën automobilistike. Luftimet në Bardhoc u zhvilluan më 25 tetor 1944. Kishim këputur në mes edhe urën dhe qëndronim në pritje ardhjen e autokolonës gjermane. Pranë meje (Uke Cami) ishin Shaqir Shira nga Zall Dardha dhe Jonuz Duka nga Maqellara. I pari hapi zjarr partizani Dine Rama nga Shumbati. Gjermanët pa urë kalimi ishin të detyruar të zbrisnin nga makinat dhe të zinin front në tokë por koha punonte për ne, sepse ne ishim të pozicionuar dhe të gatshëm për të qëlluar. Në një darë të hekurt pas katër orë luftimesh, gjermanëve u vjen përsëri ndihmë në njerëz, teknikë luftarake e logjistike. Ndërsa partizanëve pas katër orë luftimeve filluan t'u mbaronin rezervat, por edhe tërheqja ishte e vështirë. Midis Përbregut dhe Bardhosit u organizua tërheqja me luftim, por patëm të vranë e të plagosur. U plagosën Met Hajrullai, Azis Asllani etj.

Të nesërmen batalioni i parë organizoi një aksion tjetër në fund të fshatit Morin, ku asgjësohet plotësisht një kompani gjermane, por u vra edhe partizani Elez Mena nga Bllaca si dhe u plagos Met Hajrullai dhe Shuaip Baruti.

Pas tërheqjes nga Dragashi, batalioni i katërt ishte urdhëruar për të sulmuar kalanë e Prizrenit, ndërsa batalioni i parë do të sulmonte Zhurin. Brigada e pestë do të sulmonte Prizrenin. Pas gjashtë orë luftimesh, më 17 nëntor 1944, Prizreni u çlirua.

Luftimet vazhduam për çlirimin e Kukësit dhe më 18 nëntor 1944 u çlirua Kukësi. Në këto luftime nga Br.18 ranë dëshmor Shehat Halili, Shahin Kaja, Imer Alliu, Hysni Krrusa, Latif Perkola, Sadik Nurca, Xhetan Hoda, Jashar Kurtulla, Aqif Konesha, Haki Zerja, Gafur Mehmeti dhe pati shumë të plagosur.

Pastaj të gjitha forcat partizane përqendrohen për çlirimin e Kukësit.

Forcat gjermane largohen dhe përqendrohen në Shkodër.

Ndërsa forcat e Brigadës sonë ndodhen në Luginën e Valbonës në Tropojë, njoftohemi më 29 nëntor se forcat partizane kanë çliruar Shkodrën.

Më 1 janar 1945, na u dha urdhri për të kaluar në Mirditë, batalioni i parë dhe batalioni i katërt i Brigadës XVIII. Batalioni i parë do të kalonte qafën e Malit dhe batalioni i katërt do të kalonte Qafën e Kumbullës. Bora binte pa pushim dhe kishte arritur lartësinë dy metra. Duke kaluar qafën vdiqën katër partizanë. Tuneli i dëborës bllokohej në çast. Në krye të kolonës ishin Gafurr Korça, Rexhep Doda, Albert Paparisto, Ferit Muha. Alberti ishte nga Elbasani dhe nuk ishte mësuar me dimra të tillë.

Në shtëpinë e një fshatari u strehua Ferit Lleshi, Hamdi Doda, Pali Carapuli, Sali Hoxha etj. Kështu u shpërndanë dhe kaluan natën të gjithë partizanët. Nuk bëhej fjalë për të ngrënë, pasi as fshatarët nuk kishin ç'të hanin për vete, por vetëm për të futur kokën e për të shpëtuar nga ngrirja e nga vdekja.

Pasi dëbora ngriu kalonim mbi dëborë dhe udhëtuam drejt Mallkuqes, Domgjonit, Iballës e Pukës për të arritur në detyrën e re që i ishte ngarkuar brigadës.

\*(Sipas kujtimeve të babait, veteranit Uke A. Cami, efektiv i kësaj brigade)

# Gjeneralitet personal apo identikit kombëtar?

## Gjeneralitet personal apo identikit i një kombi?

Pasaporta shqiptare e viteve '30, përveç gjeneraliteteve brenda saj kishte edhe pesë këshilla mahnitëse të shkruara.

*Aty shkruhej:*

*/Të dish dhe të jesh i sigurt se fatbardhësia dhe lumturia jote gjendet në Shqipëri, e cila të jep nder e të fal emrin shqiptar.*



*/Ruaje mirë karakterin kombëtar dhe kryelartësinë shqiptare, bindu lidhjeve dhe urdhrave të vendit kudo që të jesh.*

*/Çdo shqiptar është vëllai yt, nderojë kurdoherë dhe ndihmoje kur të ketë nevojë /Mos e përbuz gjuhën e nënës tënde, duke folur gjuhë të huaja kur nuk është nevoja.*

*/Ndero flamurin e atdheut tënd, kush nuk e nderon shenjë e kombësisë, e çnderon vendin e vet.*

*/Ruaje mirë karakterin kombëtar dhe kryelartësinë shqiptare; bindu lidhjeve dhe urdhrave të vendit kudo që të jesh.*

Në pasaportat shqiptare kanë lënë gjurmë të gjitha regjimet politike të kohës. Kjo duke nisur që nga vitet 20-të shekullit të kaluar, kur për herë të parë shteti shqiptar filloi t'i pajiste nënshtetasit e tij me pasaporta për të udhëtuar jashtë shtetit.



Një pasaportë e viteve 1920-1924 ka elementë të ngjashëm, por ajo ndryshon me pasaportat e periudhës së Republikës (1925-1928) e sidomos me ato të Monarkisë (1928-1939). Përveç formës së regjimit që gjendet e stampuar në ballinën e çdo dokumenti dhe elementëve të tjerë të sigurisë, të dhënave personale etj., pasaportat e periudhës së Monarkisë ishin të pajisura me disa këshilla, që kishin për qëllim forcimin e ndjenjës së atdhedashurisë.

Por vlera dhe rëndësia e një pasaporte është në raport të drejtë me kredibilitetin politik që shteti gëzon në arenën ndërkombëtare. Nga ky këndvështrim qytetarët shqiptarë nuk kanë qenë njëlloj të vlerësuar në periudha të ndryshme historike.

Në çdo pasaportë krahas të dhënave të përgjithshme vendoseshin edhe dy elementë të rëndësishëm “besimi” dhe “kombësia”. Por në vitet 60-të, kur vala e luftës kundër fesë dhe besimeve fetare po vinte duke u rritur, prania e këtyre elementëve në pasaporta do të vihet në diskutim.

Në një shkresë drejtuar sektorit juridik të kryeministrit që mban datën 8 maj 1965, është shprehur se, ishte bërë rregull që në letërnjoftime, pasaporta dhe dokumente të tjera zyrtare të pasqyroheshin, përveç të dhënave dhe cilësive të nevojshme për përcaktimin e identitetit të shtetasit, edhe kombësia me besimin e tij fetar dhe për këtë i referohej nenit 15 të Kushtetutës, ku thuhej

se: “Të gjithë shtetasit janë të barabartë pa ndryshim kombësie, race ose feje. Çdo akt që sjell privilegje në favor të shtetasve ose që kufizon të drejtat e tyre për shkak ndryshimi në kombësi, racë ose fe, është kundër Kushtetutës dhe sjell me vete dënime të parashikuara me ligj”. Letërnjoftimi (pasaporta) është një dokument zyrtar që vërteton shtetësinë, identitetin e shtetasit (emrin, emrin e të atit dhe të nënës, datëlindjen, vendlindjen, gjendjen shoqërore dhe gjendjen familjare të mbajtësit. Të gjitha faktet që shënohen në letërnjoftim (pasaportë) quhen të pakundërshtueshme dhe kanë fuqi detyruese për çdo veprim që kryen shtetasi (martesë, etj.), gjersa nuk provohet e kundërta.

Ky i fundit nuk ishte element thelbësor i pasaportës, duke patur parasysh se çdo shtetas kishte të drejtë që të shprehej ose jo lidhur me përkatësinë e tij fetare. Por ndryshonte puna lidhur me “kombësinë”.

Kjo, sepse shtetas shqiptarë ishte ai që lindte nga prindër shqiptar, ose që e fitonte shtetësinë nga natyralizimi. Ata që e fitonin shtetësinë shqiptare me natyralizim nuk kishin

kombësi shqiptare. Kështu që element thelbësor i identitetit të çdo shqiptari mbetej kombësia.

Pavarësisht përpjekjeve për ta hequr “kombësinë” nga pasaportat shqiptare në vitin 1965 ajo nuk u bë mundur. Konfuzioni që do të shkaktonte një veprim i tillë, sot do të kishte pasoja të pallogaritshme. Shqipëria do të mbushej me pakica inekzistente nga të gjitha vendet e botës, në varësi të parave që ato do të kishin në dispozicion. Gjatë periudhës së regjimit komunist, Shqipëria nuk lejonte qytetarët e saj të udhëtonin jashtë shtetit ndaj nuk lëshonte pasaporta të zakonshme por vetëm pasaporta diplomatike dhe shërbimi në numër të kufizuar.

Pasaporta shërbimi u lëshoheshin edhe shoferëve apo studentëve shqiptarë me studime në vende të huaja por pas përfundimit të misionëve apo studimeve pasaporta duhej të dorëzohej përsëri në organet e policisë.

Me ardhjen e demokracisë autoritetet lëshojnë pasaporta për çdo qytetar që bën kërkesë dhe që përmbush kushtet e vendosura me ligj.

Pasaporta e Shqipërisë është dokument identifikimi dhe udhëtimi që përdoret nga shtetasit shqiptarë për të kryer udhëtime jashtë kufijve të Shqipërisë dhe shërben për të provuar shtetësinë shqiptare dhe për të identifikuar mbajtësin e saj.

Organi kompetent për lëshimin e tyre është Ministria e Brendshme. Mbajtësi i pasaportës shqiptare gëzon të drejtën për mbrojtje diplomatike në çdo skaj të botës kapilarisht nga Shteti shqiptar në rast të cenimit të dinjitetit, integritetit dhe të drejtave njerëzore të shtetasve shqiptarë në vendet e huaja.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

**Peqini e kishte bir dhe mësues**

Në fund të fundit komunist ishte Mustafai... në fund të fundit Mustafa Gjinishi ishte nacionalist. Po ai ishte komunist, komunist idealist dhe nacionalist se e donte Shqipërinë me Kosovë e Çamëri. Mustafai ishte më popullor, me reputacion në Shqipëri, më i respektuari, më i ëmbli, më i dashuri... Italianët dhe gjermanët Mustafa Gjinishi, Myslim Pezën... i kërkonin kudo... Mustafa Gjinishi në kryengritjen e Fierit, për aktivitetin e tij, Zogu e dënoi me varje. Por, ishin mbi 15 figura të dëgjua dhe me reputacion të Peqinit që i dërguan Zogut telegram për faljen e jetës. Populli i krahinës së Peqinit kishte Mustafa Gjinishin për idhull, bir dhe mësues të tij. Prezenca, fjalët dhe porositë, shembulli frymëzues i tij, do të bënin që nga krahina e Peqinit të dilnin në luftë shumë partizanë, duke shkuar kryesisht në Pezë, në çetën me komandant Myslim Peza dhe me komisar Mustafa Gjinishi. Pjesa më e madhe e luftëtarëve, si ilegalë dhe partizanë kërkoheshin të kapeshin nga pushtuesi, duke i etiketuar dhe si bashkëluftëtarë “të rrezikshmit” Mustafa Gjinishi. Mustafai shfletonte libra të ndryshëm në bibliotekën e pasur të dajës së tij, patriotit të njohur të Peqinit Mahmud Kaziu. Mustafai kishte për dëshirë të shfletonte në gjuhën frënge, të cilën ia mësonte daja. Shfletonte librin që fliste për Napoleon Bonopartin dhe shikonte vizatimet e pikturat në libër, betejën e Vaterlosë, luftën e Borodinos, ishullin e Elbës, ku Bonoparti u internua etj. Mustafai mësoi dhe nga fjalori i Sami Frashërit, të cilin Mahmud Kaziu e kishte si gjënë më të shtrenjtë dhe me vlera. Fjalori mbi 1000 faqe është dhe sot i ruajtur nga familja Kaziu në Peqin, i cili është botuar mbi 135 vite më parë.

Babai, Adem Gjinishi ishte një personalitet në luftën për pavarësi të vendit, kundërshtar politik i Vërlaçit dhe i Zogut. Ishte delegat në Kongresin e Lushnjës 1920, mik i ngushtë i patriotit elbasanas, Aqif Pashë Elbasani. Adem Gjinishi ishte politikan më me influencë i Peqinit e më gjerë. Ai ishte tepër guximtar, burrëror e me karakter, urrënte padrejtësitë dhe abuzimet. Shkroi në shtypin e kohës për qeverinë dhe ministrat, për pandershmëri në zgjedhje, si skandale të turpshme etj. Adem Gjinishi ishte kandidat për deputet i Partisë Popullore, opozitare me Zogun, por u vra në prag të zgjedhjeve në vitin 1923. Vrasja e tij bëri jehonë në shtypin e kohës... Babai Adem kishte fëmijë Rexhep, Mustafa, Xhemile dhe Fitnete.

**E lidhi idealin me njerëz të shquar...**

Mustafai ka lindur më 15 janar 1912 në Peqin. Prindërit e tij ishin Adem dhe Rukie Kaziu. Rexhepi, vëllai i madh u interesua për ecurinë e mësimeve të Mustafait, ku mbas shkollës unike në Peqin, vazhdoi Shkollën Teknike Amerikane të Harry Fultz-it në Tiranë, në vitet 1924-1930. Ai shkëlqeu në të gjitha drejtimit dhe ishte studenti më i vlerësuar, për maturinë, oratorinë e reputacionin që gëzonte në shkollë. Studioi në shkollë libra të iluministëve francezë Volter, Ruso etj., ishte për ide të reja progresiste. Në shkollë përqafoi idealet komuniste që ishin frymëzuese të kohës. Pas përfundimit të Shkollës Teknike ishte përfaqësuesi i Ali Kelmendit për përhapjen e ideve komuniste. Në karakterin e tij kishte dhe ide e koncepte demokratike. Shkolla Teknike u bë vatra e parë e edukimit dhe rritjes së nivelit kulturor të Mustafait e të fillimit të aktivitetit të tij patriotik, duke përqaftuar ide të reja për përparimin e vendit. Në vitet në vijim mbante lidhje me studentët e shkollës, duke përhapur aty idetë komuniste, përparimtare të kohës. Në shkollë ishte zgjedhur sekretar i klubit të letërsisë së shkollës dhe në vitin 1932 u zgjodh drejtues-sekretar i përgjithshëm i të gjithë graduantëve (të diplomuarve) të të gjithë viteve që kishin mbaruar Shkollën Teknike. Pas përfundimit të Shkollës Teknike, kërkoi të studionte për diplomaci jashtë shtetit por regjimi i Zogut, nuk i siguroi të drejtë si i dyshimtë... hapi në Tiranë dhe më pas në Kavajë librari me literaturë përparimtare të kohës...

Në vitet 1930-1935 Mustafai e lidhi idealin me njerëz të shquar si Ali Kelmendi, Riza Cerova, Skënder Luarasi, Asim Vokshi, me patriotin e tij Demir Godelli, me Tajar Zavalanin, Petro Marko etj. Në këtë rreth të shquar intelektualësh, bisedonte, punonte dhe vepronte dhe Mustafai i ri. Në Tiranë u krijuan çelulat e para të përhapjes të ideve komuniste, ku bënte pjesë dhe Mustafai. Duke mbajtur lidhje me Shkollën Teknike Amerikane, filloi të bashkëpunonte ngushtë me qarqet revolucionare në Tiranë. Nga fundi i vitit 1933 u arrestua dhe u dënua për politikë, për grupin e krijimit të partisë komuniste. Veprimtarinë politike në burg nuk e pushoi, por komunikonte me letra me shokët, bashkëpunonte dhe udhëzonte. Komunikonte me Riza Cerovën, dhe në këmishën e shokut të qelisë i shkroi letër, por letra mbërriti tek shefat e burgut dhe filluan mbi Mustafanë

# Mustafa Gjinishi, komisari i parë i çetës partizane të Pezës



torturat... ku mbas dështimit të kryengritjes së Fierit, djaloshi Mustafa Gjinishi, i cili edhe pse i burgosur qysh kohë më parë për faje politike, dënohet prapë në gjyqin politik të Fierit... patriotët e Peqinit me mençuri dhe diplomaci i kërkuar Zogut heqjen e dënimit me vdekje, “për mos me u lanë një njollë këtij populli”, u dënua me 101 vite burg. Mustafai nga burgu, nëpërmjet Demir Godellit, propozonte që të shkonin në frontin e lirisë vullnetarë në Spanjë, shokë të rinj dhe të shëndetshëm...

**Organizoi forcat komuniste dhe popullin për luftë**

Mustafa Gjinishi, para 7 prillit 1939, ishte amnistuar dhe po ngrinte zërin për pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste... emigroi në Jugosllavi. Fashistët e kërkonin në Shqipëri. Në Beograd u krijua i ashtuquajtur “Shtabi i solidaritetit me Jugosllavinë”, ku kryetar i shtabit ishte Mustafa Gjinishi. Pas dy vitesh i arratisur në Jugosllavi, kthehet në atdhe, duke hyrë nga Shqipëria e Jugut në prill 1941. U lidh me grupin komunist të Korçës dhe më pas shkoi në Pezë, ku patrioti dhe luftëtari Myslim Peza kishte ngritur çetën e tij. Bashkëpunimi me Myslim Pezën ishte i ngushtë. U bë anëtar i PKS-së që në themelimin e saj, më 8 nëntor 1941. Aksionet e para ishin: organizimi i demonstratës antifashiste më 28 nëntor 1941, në Tiranë. Ishte komisar i parë i çetës partizane të Pezës, duke pranuar komunistë në Pezë Vasil Shanton, Qemal Stafën, Mihal Durin etj. Organizoi aksionin gueril për lirin nga burgu fashist të Peqinit të Miladin Popoviçit. Bëri organizimin e forcave komuniste dhe të popullit në luftë kundër fashistëve italianë e gjermanë. Punoi për rritjen e efektivit të çetës së Pezës kryesisht nga Tirana, Durrës, Shijak, Kavajë, Peqin, Elbasan, Lushnje etj., të cilat u bënë baza të fuqishme të luftës partizane. Mustafai për këto aksione dhe përkushtimin ndaj lëvizjes, kërkohet nga milicia fashiste, i cili konsiderohej prej tyre si i “jashtëligjshëm”. Por ishte guximi i tij, që iu hodh në fyt komandantit të xhandarmërisë së Peqinit, i cili nuk bëri zë, por i dorëzoi të gjitha armët për partizanët. Kudo jepej alarmi për kapjen e të “rrezikshmit”, i cili ishte ndër më të kërkuarit nga

pushtuesi. Ai mbante pseudonime të ndryshme si “Alfi”, “Xhindi”, “Dajë”, “Tafari” etj.

Mustafa Gjinishi kontribuoi dukshëm për zhvillimin e Konferencës së Pezës më 16 shtator 1942. Idetë e tij që zunë vend ishin “luftë okupatorit pa dallim feje, krahine e ideje”. Këtu u takuan komunistë e zogistë, nacionalistë e pa parti, gjithsej 18 delegatë, të cilët zgjodhën Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar prej 8 vetash, ku 3 ishin komunistë (Y. Dishniça, E. Hoxha dhe M. Gjinishi) dhe 5 nacionalistë (M. Peza, Baba Faja, A. Kupi, N. Çoba dhe K. Qafmolla). Ishte mbledhja e parë ku të gjithë shqiptarët ishin bashkë, e nuk kishin nëpër këmbë të huaj. Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar zgjodhi kryetar nacionalistin Kamber Qafmolla dhe sekretar komunistin Mustafa Gjinishi. Dihet roli i Mustafait në këtë këshill, pasi K. Qafmolla ishte i sëmurë dhe më pas u largua nga këshilli. Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm, Mustafai ishte një ndër anëtarët e tij. Rol të dukshëm Mustafai ka luajtur dhe në Konferencën e Mukjes, ku në delegacionin e Frontit Nacionalçlirimtar bënin pjesë komunistë, zogistë, nacionalistë etj. Ndër problemet kryesore që ngriti dhe përkrahu Mustafai ishte problemi i Kosovës, i bashkimit të saj me Shqipërinë pas lufte...

**Mustafa Gjinishi ra si luftëtar i palodhur**

Meritë e veçantë e Mustafait në luftë ishte ngritja e aktivitetit të njësiteve guerile dhe formacioneve ushtarake, njësite e çetave apo dhe të krijimit të Këshillave Nacionalçlirimtare në zonat e çliruara. Në veçanti punoi për të sheshuar kontradiktat ndërmjet forcave të ndryshme politike, për t'i bashkuar ato të gjitha në luftë kundër pushtuesit. Dihet se Mustafa Gjinishi gjatë luftës vazhdimisht u mundua të sheshojë mosmarrëveshjet politike të PKS-së, të Legalitetit, Ballit Kombëtar e nacionalistëve, për t'i mobilizuar dhe organizuar në luftë këta të fundit. Në një informacion të hollësishëm si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, në momentet më të vështira të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në operacionin gjerman, më 19 dhjetor 1943, shkruan për vështirësitë dhe humbjet e forcave partizane, shkaqet, shkaktarët dhe orienton rrugët për të dalë nga kjo situatë. Ai përshkruan me objektivitet, paanshmëri, saktësi dhe qëndrim kritik, i përshkruan momente të vështira, duke kritikuar individë komunistë, por dhe ballistë, legalistë e nacionalistë si bashkëpunëtorë me gjermanët. Në maj 1943, Mustafa Gjinishi u caktua nga Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar për të qenë shoqëruesi dhe përkthyesi i misionëve angleze, koordinator i tyre në Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Në verën e vitit 1944 Mustafai u caktua nga Shtabi i Përgjithshëm dhe u dërgua në veri, në Dibër në Divizionin I Sulmues e më pas në Korpamatën I Sulmuese. Radio “Londra” në mjaft emisione të saj, kur fliste për luftën çlirimtare në Shqipëri theksonte se “me luftëtarët Mustafa Gjinishi e Myslim Peza po korrin suksese mbi armikun”. Çështja e Mukjes dhe mesazhet e radio “Londrës” për “Tafarin”, bënë që Mustafa Gjinishi, më 24 gusht 1944, të bjerë në një pritë në fshatin Grevë të Peshkopisë.

Në urdhrin e ditës të Ushtrisë Nacionalçlirimtare midis të tjerash thuhej se “ra në fushën e nderit shoku ynë Mustafa Gjinishi, anëtar i Kryesisë së Këshillit Nacionalçlirimtar dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Mustafa Gjinishi luftëtar i palodhur dhe i patrembur, pa kursyer asgjë, dha jetën në vijat e para të luftës për çlirimin e atdheut dhe të popullit shqiptar”. Për tri ditë rresht për të nderuar luftëtarin, repartet e ushtrisë ulën flamurin kombëtar në gjysmë shtizë. Ai u quajt dëshmor i rënë në luftë kundër gjermanëve në frontin e Maqellarës në Dibër. Pas çlirimit në Peqin, një shkollë dhe një rrugë morën emrin e dëshmorit Mustafa Gjinishi, si dhe një rrugë në Tiranë, por më vonë u cilësua si agjent i anglezëve dhe figura e tij mbeti në heshtje. Roli i tij në LANÇ është rivlerësuar në studimet e kryera pas vendosjes së pluralizmit politik. Sot Mustafa Gjinishi është dëshmor i atdheut. Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, me vendim nr. 9, datë 20 maj 2003, i jep Mustafa Adem Gjinishit certifikatën e Dëshmorit të Atdheut. Eshtrat e tij nuk janë në varrezat e dëshmorëve të Elbasanit. Në qytetin e Peqinit është ngritur një bust në qendër të qytetit. Për jetën dhe veprën e Mustafa Gjinishit, shkrimtari nga Peqini Astrit Kaziu ka shkruar monografinë “Legjenda Gjinishi përballë së vërtetës” në vitin 2005.

# Uji nëntokësor do të jetë shumë i nxehtë për t'u pirë deri në vitin 2100

Deri në vitin 2100, më shumë se 75 milionë njerëz ka të ngjarë të jetojnë në vende ku ujërat nëntokësorë janë shumë të nxehtë për t'u pirë, sipas një studimi të ri. Temperaturat e ujërave nëntokësore parashikohen të rriten deri në 3.5°C (6.3°F) deri në fund të shekullit, që do të thotë se ato do të tejkalojnë prapun më të lartë të vendosur për ujin e pijshëm nga çdo vend.

Uji nëntokësor është vendimtar për jetën në Tokë, dhe megjithatë dihet relativisht pak se si reagon ndaj ndryshimeve klimatike në hapësirë dhe kohë. Ajo që ne dimë është se ndërsa gjërat nxehen, ai do të veprojë si një lavaman nxehtësie, duke thithur nxehtësinë e tepërt të shkaktuar nga ngrohja globale.

Për të kuptuar se si mund të duket kjo, studiuesit në Institutin e Teknologjisë në Karlsruhe (KIT) kanë modeluar ndryshimet e parashikuara në temperaturat globale të ujërave nëntokësore deri në vitin 2100. Duke u bazuar në parashikimet e tyre në dy skenarë klimatikë, SSP 2-4.5 dhe SSP 5-8.5, të cilat reflektojnë rrugë të ndryshme të zhvillimit socio-ekonomik dhe përqendrimet e ardhshme të gazeve serrë, ata kanë përcaktuar se temperaturat e ujërave nëntokësore do të rriten me 2,1°C (3,8°F) ose 3,5°C (6,3°F), në varësi të skenarit.

Disa pjesë të botës do ta ndiejnë këtë rritje më të mprehtë, shpjegoi autorja e studimit Dr. Susanne Benz, nga Instituti i Fotogrametrisë dhe Remote Sensing në KIT, në një deklaratë: “Normat më të larta të ngrohjes së ujërave nëntokësore në botë mund të priten në vende me një grafik të varfër të ujërave nëntokësore dhe/ose ngrohje e lartë atmosferike”.

Çfarë do të thotë kjo, është se për miliona njerëz në mbarë botën, ujërat nëntokësorë do të bëhen të papijshëm.

“Ka tashmë rreth 30 milionë njerëz që jetojnë në rajone ku ujërat nëntokësorë janë më të ngrohta se sa përcaktohet në udhëzimet më të rrepta të ujit të pijshëm”, - tha Benz. “Kjo do të thotë se mund të mos jetë e sigurt për të pirë ujë të pa trajtues. Mund të jetë e nevojshme. Për shembull, uji i pijshëm ngrohet në tubacionet e ujit nga nxehtësia në tokë, në varësi të skenarit, deri në 2100”.

Në fakt, hulumtimi sugjeron që në 76 vitet e ardhshme, nga 77 deri në 188 milionë njerëz mund të preken sipas SSP 2-4.5, dhe 59 deri në 588 milionë sipas SSP 5-8.5.

Në rast se po pyesni se çfarë nuk shkon me pak ujë të ngrohtë, na lejoni të shpjegojmë. Temperatura e ujërave nëntokësore ndikon në një sërë procesesh biogjeokimike që nga ana tjetër ndikojnë në cilësinë e tyre. Për shembull, në kushte të caktuara, rritja e temperaturave të ujërave nëntokësore mund të çojë në rritjen e përqendrimeve të substancave të dëmshme si arseniku ose mangani. Këto përqendrime më të larta mund të kenë një ndikim negativ në shëndetin e njeriut, veçanërisht kur ujërat nëntokësorë përdoren si ujë të pijshëm”, - shpjegoi Benz.

Mund të lehtësojë gjithashtu rritjen e patogjenëve si Legionella spp, dhe ndikon në ekosistemet, biodiversitetin dhe ciklet e karbonit dhe lëndëve ushqyese. Në përgjithësi, nuk është një lajm i mirë për ne ose organizmat e tjerë që mbështeten në



Temperatura e ujërave nëntokësore parashikohet të rritet deri në 3.5°C (6.3°F) në disa vende

sistemet e ujërave nëntokësore.

“Rezultatet tona tregojnë se sa e rëndësishme është të ndërmerren veprime për të mbrojtur ujërat nëntokësorë dhe për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për të luftuar ndikimin negativ të ndryshimeve klimatike në ujërat nëntokësorë”, - përfundoi Benz.

## Ndikimi i ndryshimeve klimatike në disponueshmërinë dhe cilësinë e ujit

Ndryshimet klimatike, sot, përfaqësojnë një nga kërcënimet më të mëdha mjedisore në planet dhe kanë një ndikim të madh në shëndetin e njerëzve, veçanërisht të fëmijëve. Efektet e ndryshimeve klimatike ndikojnë në masën më të madhe ujin, duke shkaktuar mungesë uji, ndotje të ujit ose ujë të tepërt në një zonë të caktuar. Paneli Ndërqeveritar i OKB-së për Ndryshimet

Klimatike (IPCC) parashikon se fatkeqësitë e lidhura me ujin do të rriten si në frekuencë ashtu edhe në ashpërsi në vitet e ardhshme.

Vitet e fundit, fokusi ka qenë, ndër të tjera, tek ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tij në disponueshmërinë dhe sigurinë e ujit. Pothuajse dy të tretat e popullsisë së botës përjetojnë mungesë të madhe uji për të paktën një muaj të vitit. Të dhënat nga Organizata Botërore e Shëndetësisë tregojnë se rreth 85% e popullsisë së botës jeton në pjesën e thatë të planetit dhe se në shumë pjesë të botës disponueshmëria e burimeve ujore është në rënie. Rreth 780 milionë njerëz në botë nuk kanë akses në ujë dhe rreth 2.5 miliardë njerëz nuk kanë akses në kanalizimet e duhura. Gjithashtu, rreth 6 deri në 8 milionë njerëz në vit vuajnë nga pasojat e sëmundjeve të shkaktuara nga uji i ndotur.

Ndryshimi i klimës mund të çojë në luhatje më të mëdha në shfaqjen dhe shtrirjen e reshjeve, temperaturat e ajrit dhe një rritje përkatëse të temperaturave të ujit. Pasojat janë stuhi më intensive dhe shira të dendur, përmbytje dhe thatësira. Këto ndryshime mund të kërcënojnë cilësinë e ujërave që përdoren si burime të furnizimit me ujë: lumenj, liqene, burime dhe ujëra nëntokësore. Ndryshimet në cilësinë e ujit në burimet e furnizimit me ujë nën ndikimin e reshjeve të shpeshta dhe të dendura dhe përmbytjeve mund të komplikojnë funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë, prodhimin e ujit të pijshëm, të dëmtojnë shëndetin e tij në rubinet dhe të çojnë në ndërprerje të furnizimit me ujë dhe mungesë të ujit të pijshëm. Në të kundërt, thatësira mund të ndikojë negativisht në sasinë e disponueshme të ujit në burime, si dhe në cilësinë dhe shëndetin e tij. Mund të çojë në përqendrimin e ndotjes ekzistuese, kur niveli i ujit në lumenj bie.

Bashkëpunimi në fushën e ujit ka një dimension etik, social, politik, institucional dhe ekonomik dhe njihet si një ekuilibër i mirë midis nevojave dhe prioritetëve në këtë fushë.

Parashikimet tregojnë një rritje të mëtejshme të temperaturës, reshje më të bollshme dhe numër të ngjarjeve ekstreme të motit. Në këtë drejtim, mund të pritët që fëmijët të vuajnë në mënyrë disproporcionale më shumë sepse janë në proces të zhvillimit fiziologjik. Si rezultat i ndryshimeve klimatike, fëmijët përballen me efektet e goditjeve klimatike - ngjarjet e papritura ekstreme të motit, si valët e të nxehtë, përmbytjet dhe zjarret pyjore, të cilat po bëhen më të shpeshta dhe të rënda, si dhe me ngjarje më të ngadalta, si thatësitat dhe rritja e sëmundjeve të transmetuara nga uji.





Javën e kaluar, Ukraina bëri atë që shumë e mendonin se ishte e pamundur të ndodhte që ajo të pushtonte Rusinë, dhe, në të vërtetë, kjo ishte diçka që nuk kishte ndodhur që nga Lufta e Dytë Botërore.

Rusia pushtoi Ukrainën në vitin 2022, për të bllokuar atë që Moska besonte se ishte një rrugë e mundshme sulmi nga ana e NATO-s. Moska mendoi se Ukraina ishte e dobët dhe e ndarë dhe arriti në përfundimin se sulmi do të shkatërronte forcat ukrainase me shpejtësi dhe do të lejonte pushtimin rus. Koha ishte thelbësore. Çdo minutë që kalonte, lufta ishte një çast në të cilën SHBA-të ose NATO mund të ndërhynin. Qeveria ukrainase nuk e priste dhe për rrjedhojë nuk planifikoi një luftë të gjatë dhe të kushtueshme, dhe që atëherë e ka paguar gabimin e saj. Megjithatë, Rusia besonte se kishte ende një avantazh të rëndësishëm: dominonte fushat e betejës. Nëse Moska nuk mund të kontrollonte aspektet strategjike të luftës, të paktën mund të kontrollonte aspektet taktike. Në këtë mënyrë, ajo ishte në gjendje të mbante forcat ukrainase në mbrojtje, deri javën e kaluar, kur Ukraina pushtoi rajonin e Kurskut.

Se si Ukraina ishte në gjendje të pushtonte Rusinë nuk është ende saktësisht e qartë. Ndonjëherë një ushtri tregon një model në të cilin disa gjëra shihen si të pamundura. E ndonjëherë një ushtrie i mungon inteligjenca. Rusia filloi luftën kundër inteligjencës së dobët të Ukrainës, kështu që një gabim i ngjashëm i inteligjencës së saj nuk arriti të parashikonte një pushtim që do të ishte në përputhje me modelin që dha vetë. Nuk është sekret që Rusia i është drejtuar Koresë së Veriut dhe Iranit për armë shtesë kohët e fundit, kështu që ka mundësi që Ukraina e pa këtë si moment dobësie ruse.



Ushtria e Kievit shënon përparim

Kryekomandanti i ushtrisë ukrainase, Oleksandr Syrskiy, tha, më 13 gusht 2024, se forcat ukrainase kanë marrë nën kontroll 74 vendbanime në rajonin Kursk të Rusisë. Gjenerali Syrskiy e informoi presidentin Volodymyr Zelensky përmes një videolidhjeje, duke i treguar atij se ushtria e Kievit ka shënuar përparim në drejtime të ndryshme deri në 3 kilometra në 24 orët e fundit, si dhe ka zënë territor të ri prej 40 kilometra katrorësh.

Zelensky tha në “Telegram” se është në kontakt të vazhdueshëm me Syrskiyn, për të pranuar raportet nga fronti dhe nga rajoni i Kurskit. Me gjithë vështirësitë dhe betejat intensive, përparimi po vazhdon, tha ai. “Unë u jam mirënjohës ushtarëve tanë për shërbimin e tyre heroik”, - tha ai.

Më vonë, Zelensky tha në një videomesazh se qindra ushtarë rusë janë dorëzuar në duart e forcave ukrainase në rajonin e Kurskit dhe se të gjithë atyre u garantohet trajtim njerëzor. Disa analistë të luftës kanë thënë se Ukraina mund ta ketë nisur inkursionin për t’i bërë forcat e Kremlinit të largohen nga vija e frontit dhe të kthehen për ta mbrojtur Kurskin dhe zonat e tjera kufitare. Por, Shtabi i Përgjithshëm i Ukrainës tha se forcat e Kremlinit i kanë rritur sulmet në lindje të Ukrainës.

Sipas Shtabit të Përgjithshëm, në 24 orët e fundit trupat ruse kryen 52 sulme në zonën e Pokrovskit, një qytezë në rajonin Donjeck të Ukrainës, i cili ndodhet afër vijës së frontit. Ky është përafërsisht dyfishi i sulmeve ditore në këtë pjesë para një jave. Ministri i Jashtëm i Ukrainës, Dmytro Kuleba, tha më 13 gusht se e ka njoftuar shefin e BE-së për politikë të jashtme, Josep Borrell, për operacionin e Kievit në rajonin e Kurskit.

Forcat ukrainase e filluan inkursionin befasues në rajonin e Kurskit më 6 gusht dhe kanë kapur deri tani rreth 1.000 kilometra katror territor dhe qendra të shumta banimi. Nuk është e mundur të verifikohen pretendimet nga fushëbetëjat, edhe pse është raportuar se forcat ukrainase janë futur edhe më thellë brenda Rusisë.

Realiteti i ri në Luftën e Ukrainës, çfarë po ndodh me Rusinë?



Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Ukrainës, Heorhiy Tykhy, tha më 13 gusht gjithashtu se “Ukraina nuk është e interesuar ta marrë territorin e rajonit të Kurskit”. Ai tha se Rusia ka kryer më shumë se 2.000 sulme nga rajoni i Kurskit në muajt e fundit, duke përdorur raketa kundërajrore, artileri, mortaja, dronë, 255 bomba dhe më shumë se 100 raketa. “Qëllimi i këtij operacioni është mbrojtja e jetës së fëmijëve, mbrojtja e territorit të Ukrainës nga sulmet ruse. Këto veprime të Ukrainës janë plotësisht të ligjshme”, - tha ai.

Guvernatori në detyrë i Kurskit, Aleksei Smirnov, raportoi para presidentit rus, Vladimir Putin, më 12 gusht, se 28 vendbanime “janë nën kontrollin e armikut”.



Ukraina godet Rusinë me dronë dhe përparon thellësi

Edhe më 14 gusht Ukraina goditi rajonet ruse me raketa dhe dronë, ndërsa Kiev i tha se po përparonte më thellë në operacionin më të madh të huaj në Rusi për disa dekada, për të cilin Shtëpia e Bardhë paraqet një “dilemë të vërtetë” për presidentin rus Vladimir Putin.

Kur mijëra trupa ukrainase kaluan kufirin rus në orët e para të 6 gushtit në rajonin perëndimor të Kurskut të Rusisë, presidenti Putin e quajti një provokim të madh që kishte për qëllim të siguronte një pozicion më të fortë në bisedimet e mundshme të armëpushimit në të ardhmen.

Në këtë zhvillim të sikletshëm për Rusinë, Ukraina zuri një pjesë të Kurskut dhe megjithëse presidenti Putin tha se ushtria ruse do t’i zmbrapste forcat ukrainase, betejat intensive të saj deri më tani nuk kanë arritur t’i dëbojnë ato.

“Situata mbetet ende e vështirë, - shkruan Yuri Podolyaka, një blogger ushtarak pro-rus me origjinë ukrainase. - Armiku e ka ende iniciativën dhe kështu, megjithëse ngadalë, po rrit praninë e tij në

rajonin e Kurskut”.

Ndërkohë Rusia njoftoi më 14 gusht se kishte shkatërruar 117 dronë ukrainas gjatë natës, kryesisht në rajonet Kursk, Voronezh, Belgorod dhe Nizhny Novgorod. Ajo tha se kishte rrëzuar edhe raketa dhe publikoi pamje të bombarduesit “Sukhoi Su-34”, duke goditur pozicionet ukrainase në Kursk. Por raporte të pakonfirmuara thanë se disa nga dronët ukrainas goditën bazat ajrore ruse. Garda Kombëtare e Rusisë ndërkohë njoftoi se po forconte sigurinë në termocentralin bërthamor të Kurskut, i cili është vetëm 35 km larg nga zona e luftimeve. Edhe pse komandantët rusë thanë se fronti në Kursk ishte stabilizuar, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se forcat e tij po vazhdonin të përparonin atje dhe urdhëroi gjeneralët e tij të zhvillonin “hapat e ardhshëm thelbësorë” të operacionit.

Ndërsa Presidenti i SHBA-ve, Joe Biden, tha se zyrtarët amerikanë ishin në kontakt të vazhdueshëm me Ukrainën lidhur me operacionin, për të cilën ai tha se kishte “krijuar një dilemë të vërtetë” për presidentin Putin, i cili dërgoi mijëra trupa në Ukrainë në vitin 2022. Por Shtëpia e Bardhë tha se Ukraina nuk dha njoftim paraprak për operacionin e saj dhe se Shtetet e Bashkuara nuk kishin asnjë përfshirje në të, megjithëse zyrtarët rusë kanë sugjeruar se mbështetësit perëndimorë të Ukrainës duhet të kenë ditur për sulmin.

Me sa duket ndërhyrja në Kursk kishte për qëllim të detyronte Rusinë të tërhiqte trupat nga Ukraina, për të mbrojtur territorin rus kundër sulmit ndërkufitar.

Sulmi ukrainas mbi Rusinë, më i madhi nga një forcë e huaj që nga Lufta e Dytë Botërore, ka ndryshuar në mënyrë dramatike rrëfimin rreth luftës, sepse Rusia kishte përparuar pas dështimit të kundërofensivës së Ukrainës në vitin 2023.

Rusia në pozicion mbrojtje, shpall gjendjen e jashtëzakonshme në rajonin e Belgorodit

Presidenti Putin tha më 12 gusht se Ukraina “me ndihmën e padronëve të saj perëndimorë”, po synonte të përmirësonte pozicionin negociues të Kievit përpara bisedimeve të mundshme të paqes dhe të ngadalësonte përparimin e forcave ruse. E zyrtarët rusë thonë se Ukraina po përpiqet t’u dëshmojë mbështetësve të saj perëndimorë se ende mund të kryejë operacione të mëdha ushtarake, ndërsa rritet trysnia si mbi Kievin ashtu edhe mbi Moskën për të rënë dakord për të biseduar për përfundimin e luftës.


Duke sjellë luftën në Rusi, Ukraina ka detyruar gati 200,000 rusë të evakuhohen nga rajonet kufitare pranë vendit të betejës së Kurskut të Luftës së Dytë Botërore, ku në vitin 1943 Ushtria e Kuqe mundi forcat naziste, në një nga fushëbetëjat më të mëdha në botë.

Guvernatori i rajonit kufitar rus të Belgorodit, Vyacheslav Gladkov, shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në mbarë rajonin, më 14 gusht 2024, për shkak të, siç tha, sulmeve të vazhdueshme nga forcat ukrainase. “Situata në rajonin e Belgorodit vazhdon të jetë jashtëzakonisht e vështirë dhe e tensionuar”, - tha ai në një video të postuar në aplikacionin e mesazheve “Telegram”. Bombardimet e përditshme nga forcat e armatosura ukrainase kanë shkatërruar shtëpi, duke vrarë dhe plagosur civilë, shtoi ai.

Por ndërkohë operacioni sjell rreziqe për Kievin. Ukraina mund të lërë të pambrojtura pjesë të tjera të frontit, duke dërguar forcat për të luftuar në territorin sovran rus. Rusia kontrollon 18 për qind të territorit ukrainas dhe ka përparuar muajt e fundit. Ukraina pretendon se kontrollon të paktën 1,000 km katrorë të Rusisë, më shumë se dyfishi i asaj që tregojnë shifrat e Moskës. Agjencia e lajmeve shpesh nuk janë në gjendje të vërtetojnë në mënyrë të pavarur situatën në fushën e betejës.

Ukraina zyrtare tha më 13 gusht se nuk ka interes që ta mbajë për një kohë të gjatë territorin që ka arritur ta vërë nën kontroll, por se ndërkohë, mund të vështirësojë përpjekjet e Moskës për të çuar më përpara trupat e saj në vijën e frontit, në lindje të Ukrainës.

# LOJËRAT OLIMPIKE "PARIS 2024", SHQIPËRIA SHKRUAN HISTORINË ME DY MEDALJE BRONZI



## Valiev dhe Dudaev: Synojmë medalje të artë, Shqipërinë e kemi në zemër

**C**hermen Valiev dhe Islam Dudaev ishin dy heronjtë e Shqipërisë në Lojërat Olimpike "Paris 2024". Ata që të dy janë sportistë të Sport Klub Tirana dhe shënuan rezultatin historik, duke fituar dy medaljet e para olimpike për Shqipërinë, në disiplinën e mundjes. Chermen Valiev dhe Islam Dudaev shkruan historinë për vendin tonë në Olimpiadë, duke sjellë dy medalje të bronzta, të parat për përfaqësuesen shqiptare në këtë eveniment dhe që nuk kishte ndodhur kurrë më parë.

Delegacioni që përfaqësoi Shqipërinë në Lojërat Olimpike "Paris 2024" mbërriti në Tiranë, më 12 gusht 2024. Ata u pritën, me një ceremoni të dedikuar, tapet të kuq dhe me lule. Në dalje të aeroportit, qindra tifozë ishin prezent për të pritur dy kampionët kuqezi.

Pasi mbërritën në Rinas dhe sollën dy medaljet e para historike për vendin tonë, Chermen Valiev dhe Islam Dudaev folën për mediat edhe pse jo me shumë fjalë, ata folën në shqip për këtë arritje, duke shprehur që në Lojërat e tjera Olimpike të arrijnë një sukses edhe më të madh. Në fjalën e tyre, të dy sportistët thanë se kërkojnë medalje të arta për vendin tonë.

"Faleminderit Shqipërisë, e kam në zemër", - tha Valiev, që shtoi entuziazmin te tifozët. Ndërsa Islam Dudaev nga ana e tij tha se synon edhe më tepër, duke kërkuar medaljen e artë. "Jam shumë i lumtur, do Zoti në herën tjetër medalje të artë për Shqipërinë", - tha Dudaev, duke shpërthyer entuziazmin mbështetësit e tij në ovacione dhe duartrokitje.

Edhe kreu i Federatës Shqiptare të Mundjes në një prononcim për mediat vlerësoi sportistët që i siguruan Shqipërisë dy medalje bronz në lojërat Olimpike. Ai tha se rrugëtimi dhe misioni tashmë ishte përbushur. "Jam



krenar për atë që kemi bërë. Falënderoj të gjithë. Është një rrugëtim dhe mision i përbushur tashmë, dhe shpresoj që ky rrugëtim mos të mbarojë këtu", - tha kreu i Federatës Shqiptare të Mundjes, Sahit Prizreni.

Duke futur Shqipërinë në listën e medaljeve olimpike dhe duke shkruar historinë për sportin shqiptar, Chermen Valiev dhe Islam Dudaev, ngritën flamurin kuqezi në Paris, duke bërë ëndërrën realitet, flamurin e Shqipërisë dhe flamurin e Sport Klub Tiranës, që është thelbi i ekipit olimpiq shqiptar. Këta sportistë u kthyen në ambasadorët më të mirë të Shqipërisë, e cila kishte synim një medalje Olimpik dhe ia doli me dy, që janë të parat gjithashtu edhe për klubin dhe për atletët shqiptarë. Duke bërë që flamuri shqiptar të shkonte në majat më të larta të aktiviteteve sportive, siç janë lojërat olimpikë, këta sportistë janë gur themeli për të ardhmen e sportit dhe për të dhënë mesazhin se për sportin duhet bërë më shumë.

Fitues i këtyre Lojërave Olimpikë u shpall ekipi i SHBA-së me 40 medalje ari, 44 argjend dhe 42 bronz, 126 në total. SHBA-ja rikthehet edhe një herë të jetë dominues në evenimentin më të rëndësishëm sportiv në glob. Përcaktues në këtë rezultat final ishte medalja e fundit e artë e fituar nga femrat në basketboll të cilat mposhtën Francën me rezultatin e ngushte 67-66. Në vendin e dytë u rendit Kina me 40 medalje ari, 27 argjend dhe 24 bronz, 91 medalje në total. Në vendin e tretë Japonia, e ndjekur nga Australia dhe Franca.



Me një ceremoni mbresëlënëse, Parisi mbylli këto Lojëra Olimpike, për t'i lënë stafetën Los Anxhelos, vendi që do të mirëpres Lojërat Olimpike në 2028.

**Ecuria e Shqipërisë në Lojërat Olimpike “Paris 2024”**  
Paris për shqiptarët do të kujtohet përjetësisht si qyteti ku për herë të parë siguruam medalje olimpike, madje jo një, por dy të tilla, dy medalje bronz që e vendosin Shqipërisë mes vende që kanë fituar medalje olimpike.

Mundja kuqezi dhuroi spektakël, kur Valiev dhe Dudaev siguruan dy medalje olimpike, me shpresën që ky të jetë një fillim i ri. Në fund të Lojërave Olimpike, dy medaljet e mundjes e vendosin Shqipërinë në vendin e 80-të nga 91 shtete pjesëmarrëse.

Ishte data 10 gusht kur Chermen Valiev shkroi historinë në “Paris 2024”. Ai fitoi medaljen e parë për Shqipërinë në historinë e Lojërave Olimpike, duke mposhtur me rezultatin 6-2 në finalen për medaljen e bronzit Viktor Rassadin nga Taxhikistani, në stilin e lirë në mundje në peshën deri në 74 kg.

Pas të parës erdhi medalja e dytë për Shqipërinë nga mundësi Islam Dudaev, i cili mundi numrin një të botës në peshën 65 kg, hungarezin Ismail Muszukajev, në kategorinë stil i lirë. Veç dy sportistëve që i dhuruan medalje vendit tonë, pjesë



e këtij eventi ishin edhe gjashtë sportistë të tjerë që nuk mundën të siguronin medalje.

Sot sportistët elitarë të ngjyrave të Shqipërisë në kompeticionet ndërkombëtare, jo vetëm shpërblehen më mirë se sa në shumë vende të Europës për rezultatet e larta në arenën e më të mirëve, po as nuk mbeten më pa mbështetje “kur varin këpucët e garave në gozhdën e fundit të aktivitetit sportiv”. Ata janë të integruar në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, me grada sipas rezultateve, pagë deri në fund të jetës aktive, si edhe pension në bazë të gradës. Madje në këtë grup nderimi kombëtar, përfshihen edhe kampionët olimpike të Kosovës.

**Kush është Chermen Valiev, që i dha Shqipërisë medaljen e parë Olimpikë në histori**

Chermen Akhsarbekovich Valiev ka lindur, më 10 dhjetor 1998, në Osetinë e Veriut në Rusi dhe aktualisht është një mundës i stilit të lirë që garon në 74 kilogramë për Shqipërinë.

Për vendlindjen e tij, Rusinë, Valiev ka fituar një titull kampion

bote dhe një Evropian për U23, një kampion kombëtar rus dhe është fitues i shumëfishtë medaljeve të arit në turnetë ndërkombëtare.

Që nga transferimi në Shqipëri në vitin 2024, Valiev u kualifikua për të përfaqësuar Shqipërinë në Lojërat Olimpikë Verore 2024, në Paris duke u renditur i treti në Turneun Olimpik Botëror të Kualifikimit. Shqipëria ka marrë pjesë në dhjetë turne të Lojërave dhe pjesëmarrja e mundësit Chermen Valiev në ekip i dha Shqipërisë medaljen e parë historike në Lojërat Olimpikë, duke siguruar të bronzit në stilin e lirë deri në 74 kilogramë.

Në dhjetë pjesëmarrjet e vendit tonë në Olimpiada, kjo është hera e parë që kuqezinjtë marrin medalje. Veç anës morale dhe suksesit absolut, si dhe vlerës monetare nga shteti shqiptar, Valiev merr edhe gradën honorifike ushtarake ‘kolonel’.

**Epilogu, mbyllen Lojërat Opimpike “Paris 2024”**  
Në ndryshim nga ceremonia hapëse, me një ditë me shi në lumin Senë, ceremonia mbyllëse nisi pas perëndimit të diellit në kryeqytetin francez. Kënga e Edith Piaff “Sous le ciel de Paris” (“Nën qiellin e Parisit”), kënduar nga Zaho de Sagazan dhe kori i Akademisë “Haendel-Hendrix” shënuan fillimin e ceremonisë të mbylljes së Lojërave Olimpikë në Paris.

Kjo ishte një shfaqje e planifikuar që të zgjaste për gati tre orë në “Stade de France”, që përfshiu dorëzimin për në Lojërat e ardhshme 2028 në Los Anxhelos.

Sensacioni francez i notit, Léon Marchard, simbolikisht mori flakën nga kazani olimpike, në kopshtet e Tuileries, për në stadium, ku edhe u shua më vonë, sipas DPA.

Rreth 270 interpretues mahnitën spektatorët në stadium dhe miliarda të tjerë në mbarë botën përmes televizionit dhe transmetimeve të drejtpërdrejta, në fund të Lojërave që u hapën, më 26 korrik.

Në këtë ceremoni u përfshinë edhe Billie Eilish, Red Hot Chillie Peppers dhe Snoop Dogg. Parada e atletëve nuk ishte sipas vendit, por në një përzierje kombesh, me mbajtës të flamurit, duke përfshirë heroin francez të regbit Antoine Dupont, notaren amerikane Katie Ledecky dhe triathletin britanik Alex Yee.

U përfshi gjithashtu ceremonia e fitores për maratonën e femrave, e fituar nga holandezja Sifan Hassan, 36 orë pas një bronz në 10 000 metra dhe shtatë ditë pas një bronz në 5 000 metra.Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach mbylli zyrtarisht Lojërat, të fundit të tij pasi ai do të largohet vitin e ardhshëm, ndërsa krye bashkiakja e Parisit, Anne Hidalgo i dorëzoi flamurin olimpike homologes së saj të Los Anxhelosit, Karen Bass, të cilin më pas e mori ylli i Hollivudit, Tom Cruise.

Ceremonia e mbylljes së Lojërave u mbajt para 71 500 spektatorëve në stadiumin “Stade de France”, të cilët duartrokritën gjatë parakalimit të rreth 9 000 atletëve, me flamuj të shteteve të tyre në duar.



## Vijojnë regjistrimet e kandidatëve për:

- Ushtar / Detar aktiv; (afati i dorëzimit të dokumentacionit deri, më 26 Gusht 2024)
- Kursi për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura;  
(afati i dorëzimit të dokumentacionit deri më 23 Gusht 2024)

Për më shumë informacion na kontaktoni në numrin e telefonit:

**+ 355683404896**